

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7489 E martë 1 Gusht 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

## Opinion i Ditës

**U**mbushën plot 80 vite që Ndre Mjeda nuk jeton... Ishte 1 gushti 1937, kur u fik në Shkodër... Ndokush do të thotë: "Ah, ah ai poeti i 'Vajit të Bilbilit'... Ai prifti..."  
Vijon në faqen 20-21

## Nga PËRPARIM KABO

**Mjeda pas 80 vitesh... heshtja nuk ka vend!**



## Opinion i Ditës

**N**jë nga problematikat që po prodhon vëra e 2017 është populizmi i kryeministrit, i cili po zhvlerëson rrufëshëm institucionet. Shohim se afshohen...  
Vijon në faqen 21

## Nga FERDINAND XHAFERRI

**Populizmi i Ramës dhe ambasadorët e Perëndimit**



Kryeministri kërkon ndryshime, reagimet

## Rama, drejtorëve të spitaleve: Keqmenaxhuat, ikni nga detyra

Lista me 19 emrat që largohen, shpëtojnë 3 drejtuesit e Tiranës

Nga DARINA TANUSHI

Kryeministri Edi Rama u kërkoi dje, të gjithë drejtuesit të spitaleve në rrethe përveç 3 krerëve të spitaleve në Tiranë, të japin dorëheqjen për keqmenaxhim të institucioneve. Në një takim të ...

Në faqen 3

## POLICIA E VLORES: MORI 6 PLUMBA NE TRUP. MERREN NE PYETJE 10 PERSONA

# VRASJA E "RENIT", JA SI I SHPETOI PARVJET ATENTATIT

Ngjarja në Lungomaren e Vlorës, detajet e reja mbi 37-vjeçarin e ekzekutuar. Ngatërresa e atentatorëve me nipin e vrarë në Durrës



(Në foto) Vendi i vrasjes së 37-vjeçarit në Vlorë. Viktima, Renato Omeri

Në faqen 9

## KASTRIOT DERSHVI

**Dosjet e motrës së Kadaresë dhe Asamble Hatibit, që shante Enver Hoxhën**

Në faqen 12

## FLET EDHE BABAI I SAJ

**Gruaja që u filmua me dashnorin: Turp të ketë im shoq, njeri jam edhe unë!**

Në faqen 8

## LIBRI PER 'BEGSAT'

**Arkivi i Shkollës së Bashkuar, kush ka dhënë mësim në këto 45 vite**

Në faqen 18-19

## PRANGA AUTORIT

**Konflikti për kanalin vaditës, në Vaun e Dejës vritet 50-vjeçari**

Në faqen 8



**Shezai Rrokaj: Si kalova nga jeta akademike në politikë**

Suplement

Libri "Shkrimtarët dhe artistët nën diktatin komunist...". Dokumentet sekrete

## Kontrata e ministres Tefta Cami me francezët për "Gjeneralin..."

Drejtori i Kinostudios: Zoti Piccoli, s'jua plotësojmë dot kërkesat tuaja për "Gjeneralin..."

Nga DASHNOR KALOÇI

**N**ë mesin e vitit 1982, kur shoqëria filmike franceze "FLMSS 66", e përfaqësuar nga aktori i njohur Michel Piccoli, ishte bërë gati për të ardhur në Shqipëri dhe për të filluar xhirimet e filmit "Gjenerali i ushtrisë



së vdekur", sipas skenarit të përshtatur nga romani me të njëjtin titull të shkrimtarit të njohur Ismail Kadare, papritur u ndeshën me një sërë problemesh të ngritura nga pala shqiptare, e cila iu propozonte për një shtyrje të fillimit të xhirimeve. ...

Në faqen 10-11

## SITUATA POLITIKE REAGIMET

Kundërshtarët e Bashës kërkojnë brenda vjeshtës kuvend të jashtëzakonshëm

### Lëvizja për ringritjen e PD: 11 pika për rregullat e reja në parti



krijimin e rregullave të garta për sistemin e karrierës dhe meritës në të gjitha nivelet, përcaktimin e procedurës dhe kritereve për miratimin e kandidatave për deputetë dhe kandidatave të tjera

elektorale, që duhet të shqyrtohen dhe propozohen nga anëtarësia, ndalimin e çdo marrëveshjeje me kundërshtar politik pa marrë më parë miratimin e kuvendit kombëtar, disa rregulla për

Këshillin Kombëtar, krijimin e një gjykatë brenda partisë dhe krijimin e një këshilli të urtësh, si organ i përhershëm këshillimor. Në deklaratën e lëvizjes së kundërshtarëve të Bashës në Partinë Demokratike kërkohet ngritja e menjëhershme e një komisioni të posaçëm në shtator. Më herët, Basha ka propozuar zgjedhjen e kryetarit të partisë çdo dy vjet, si dhe fuqizimin e anëtarësisë duke zvogëluar kompetencat e kryetarit për vendimmarrje të rëndësishme, përfshirë edhe zgjedhjen e kandidatëve për deputetë dhe kryebashkiakë.



Kryetari i PD-së sulmon kryeministrin: Po të fliste Balili, gjysma e ministrave do rrëzohej

# Basha: Kriminelët e vërtetë do qeverisin vendin

"Koka e kthimit të Shqipërisë në plantacion kanabisi është Tahiri"

Kryetari i PD-së, Lulzim Basha ironizoi dje, deklaratën e kryeministrit Rama për të luftuar elementët kriminalë në vend. "Me seriozitetin tragjikomik që e ka pushtuar, Edi Rama shpalli sot (dje) para botës një tjetër betejë historike: luftën heroike kundër kanabisit dhe grupeve kriminale të lidhura me drogën. Por, tashmë, dihet se heroizmi i vetëm i Ramës është të arrestojë keqbërësit e vegjël, ata që nuk janë aq të mëdhenj sa të kenë lidhje me pushtetin", - ka thënë Basha. Sipas tij, koka e kthimit të Shqipërisë në plantacion kanabisi është Saimir Tahiri, aq sa edhe partnerët e huaj i vunë ultimatum Ramës për largimin e tij. "Por ata që presin që aksioni i Ramës të prekë Tahirin do të zhgënjehen. Trafikanti ndoshta më i madh i drogës në Shqipëri është Klement Balili, të cilin Edi Rama e la të lirë edhe pse e kërkonte qeveria e SHBA-ve, sepse po të fliste Balili, rrëzohej gjysma e ministrave. Prandaj, ata që presin që me aksionin e tij Rama të arrestojë Balilin, do të zhgënjehen", - ka



thënë Basha. Sipas tij, një tjetër trafikant droge, ndër më të kërkuarit në Evropë, është vëllai i Fatmir Xhafajt. "Por, shton kreu i PD-së, edhe në këtë rast ata që presin që aksioni i Ramës ta arrestojë atë do të zhgënjehen". "Aksioni i Edi Ramës

do të arrestojë ca fshatarë të varfër dhe ca kriminelë të vegjël. Kriminelët e vërtetë do të qeverisin vendin së bashku me Ramën, derisa populli t'i largojë", - ka shtuar Basha. Deklarata e kreu të PD-së, erdhi pas takimit që kryeministri

pati me drejtues të lartë të policisë dhe Ministrisë së Brendshme për situatën e kanabisit në vend. Pak ditë më parë, Basha, në një postim të tij në "Facebook" tha se "Shqipëria është e para në botë për përqindjen në përdorimin e kokainës për banor". Këtë ai e bazoi në një raport të zyrës së Kombeve të Bashkuara për drogën dhe krimin, i cili pohonte me fakte atë që opozita ka denoncuar pa pushim këto vite, sipas Bashës, se Shqipëria është një ndër vendet kryesore në botë të prodhimit dhe trafikimit të drogës dhe se droga ka hyrë tashmë në familjet e shqiptarëve, të cilët po kthehen në përdorues droge". "Me gjakftohtësi kriminale Edi Rama iu dha shqiptarëve alternativën e drogës dhe jo të punës dhe investimeve. Pasoja e këtij veprimi antikombëtar tani kanë filluar të ndihen kudo.

Edi Rama di të qeverisë vetëm përmes grabitjes dhe drogës. Droga dhe krimi po shkatërojnë të ardhmen tonë, prandaj duhet të bëhemi të gjithë bashkë kundër tyre", - tha Basha, pak ditë më parë.

### Nard Ndoka: Rama t'i bëjë thirrje Edi Ramës të dorëhiqet

Kryetari i PDK-së, Nard Ndoka ka komentuar në rrjetet sociale takimin e Edi Ramës me drejtorët e spitaleve, të cilëve iu kërkoi dorëheqjen brenda 24 orëve, njësoj si për krerët e hipotekave. Përmes një statusi në "Facebook", ish-ministri i Shëndetësisë shkruan se Rama i përdori për vota në zgjedhjet e 25 qershorit dhe tani po i flak. Duke ironizuar, Ndoka thekson se reformë mbi reformat do ishte që Rama t'i bënte thirrje Edi Ramës të dorëhiqet. "Rama, mbasi u caktoi të gjithë drejtorëve 'parcelat' për vota në fushatë dhe ata blenë vota sa mundën, tashti pas zgjedhjeve po kujtohet, se nuk paskan punuar mirë për katër vite!", shprehet në këtë status, ish-ministri i Shëndetësisë, Nard Ndoka.

### Tabaku: Drejtorët kanë vjedhur me bekimin e kryeministrit

Deputetja demokrate, Jorida Tabaku deklaroi dje, se është sistemi dhe jo njerëzit që e kanë katandisur vendin dhe institucionet e tij në këtë gjendje. Në një status të saj në "Facebook", Tabaku shkroi dje, pas kërkesës së Ramës për drejtorët e spitaleve që të dorëhiqen: "Ironikisht, drejtorët e hipotekave, të spitaleve, të burgjeve, tatimeve e kështu me radhë, janë thjesht ushtarë partiakë të emëruar me lista partie, që janë denoncuar me kohë, ato janë emërim nga një deputet apo nga një tjetër sipas interesit apo kuotës së paguar. Një prej detyrave të tyre ka qenë ajo e ushtarit të bindur, i cili ndër të tjera duhet të zbatojë vullnetin politik të Rilindjes dhe madje të vetë kryeministrit Rama". "Nëse kanë vjedhur; abuzuar apo edhe kanë kthyer korrupsionin në praktikë... kanë vepruar me bekimin dhe miratimin e kryeministrit", tha ajo.





Pas hipotekave, kryeministri kërkon ndryshime në drejtimin e spitaleve rajonale

# Rama, drejtorëve të spitaleve: Keqmenaxhuat, ikni nga detyra

Lista me 19 emrat që largohen, shpëtojnë 3 drejtuesit e Tiranës

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama u kërkoi dje, të gjithë drejtuesve të spitaleve në rrethe përveç 3 krerëve të spitaleve në Tiranë, të japin dorëheqjen për keqmenaxhim të institucioneve. Në një takim të zhvilluar dje në Kryeministri, ku mungoi ministri teknik i Shëndetësisë, Rama u shpreh: "Spitalet tona dhe unë besoj që një ndër shkaqet themelore e të pathëna, edhe për një dozë të madhe negativiteti me të cilën është ngarkuar figura e mjekut në Shqipëri, vjen nga keqmenaxhimi i spitaleve". "Natyrisht, mjekët kanë përgjegjësinë e tyre, por është detyra e menaxhimit që t'i motivojë, të bëjë që ata të gjenden në kohën e duhur dhe në vendin e duhur dhe të mos mjaftohet me deklaratat shtypi keqardhjeje, kur sulmohet pastaj një mjek, që është pa diskutim një fenomen barbarie, por edhe një fenomen, të cilin ne do ta shohim në brendësinë e tij si shprehje edhe e një energjie që akumulohet në territoret e spitaleve për shkak të keqmenaxhimit", - u shpreh Rama. "Sot, spitalet tona nuk janë pasqyrë e pastërtisë dhe higjienës. Përgjegjësinë për këtë e kemi ju që jeni këtu, drejtuesit e spitaleve! Territore spitalësh pis, mjedise spitalësh pis. Thjesht që kanë nevojë për të pasur sy dhe për të pasur duar. S'ka nevojë as për para, as për infrastrukturë, as për reforma, as për plane madhështore", - u shpreh kryeministri. "Nuk dua të bëj krahasime pa vend, por nuk besoj se spitalet përpara vitit '90 ishin shumë më të mira se infrastrukturës moderne, të pajisjeve moderne, të ultra financimit. Ama,



**ZYRA**  
Kryeministri Edi Rama lajmëroi dje në "Facebook", se pranë Kryeministritë do të hapet Zyra e re e Bashkëqeverisjes. Për këtë arsye, atje do të punësohen 40 persona, të cilët do të punojnë me dy turne. Për të shkuar deri atje, kryeministri paraqet edhe një adresë ku do të bëhen aplikimet Zyrebashkeqeverisjes@kryeministria.al.

**DREJTORËT E SPITALEVE NË QYTETE QË LARGOHEN:**

1. Drejtor spitali në Lezhë, Pashko Smaçi
2. Drejtor spitali në Gjirokastrë, Përparim Muco
3. Drejtor spitali në Vlorë, Bruna Mersini
4. Drejtor spitali në Kukës, Hasije Zeneli
5. Drejtor spitali në Mirditë, Lek Reçi
6. Drejtor spitali në Kukës, Hasije Zeneli
7. Drejtor spitali në Elbasan, Desantila Tahiraj
8. Drejtor spitali në Përmet, Elda Cullure
9. Drejtor spitali në Sarandë, Arjan Kalcuni
10. Drejtor spitali në Gramsh, Qemal Zani
11. Drejtor spitali në Durrës, Viola Cikalleshii
12. Drejtor i spitalit në Tepelenë, Stoli Selmani
13. Drejtor i spitalit të Pogradecit, Genti Çala
14. Drejtor i spitalit të Beratit, Ildir Frashëri
15. Drejtor i spitalit të Fierit, Brunilda Çami
16. Drejtor i spitalit të Shkodrës, Përparim Çela
17. Drejtor i spitalit të Korçës, Edlira Bode
18. Drejtor i spitalit të Dibrës, Beqir Bici
19. Drejtor i spitalit të Lushnjës, Ramazan Doko

**Nuk ikën nga detyra:**

1. Drejtor i Spitalit të Traumës, Gjovalin Bushi
2. Drejtor i spitalit "Shefqet Ndroqi", Perlat Kapisyzi
3. Drejtor i Qendrës Spitalore Universitare (QSUT), Enkelejdi Joti

po të bëjmë një krahasim të nivelit të higjienës dhe të nivelit të gatishmërisë së personelit, nuk jemi 27 vjet përpara, por jemi 270 vjet mbrapa. Kush e ka përgjegjësinë për këtë? Drejtimi i spitaleve, menaxhimi. E kemi ju!", iu drejtua ai menaxherëve të spitaleve. Por, ai i mori si shembuj spitalet e Tiranës, si QSUT, spitali "Shefqet Ndroqi", apo

Spitali i Traumës. "Jo vetëm mbani përgjegjësi që nuk kemi bërë një kërkesë të vetme, por mbani përgjegjësi për faktin që si pasojë e mosbërjes së këtyre kërkesave, njerëzit në nevojë të këtyre shërbimeve turren të gjithë në Tiranë. Mbani përgjegjësi për shërbimet e tyre ekstra, se duhet të marrin rrugën për të ardhur deri këtu, e jo vetëm, por bash-

kë me familjarët që i shoqërojnë", - theksoi Rama. "Është e qartë që largimi juaj menjëherë nesër nga detyra nuk është zgjidhja e këtij problemi, po është vetëm fillimi i zgjidhjes. Objektivi është autonomia spitalore, por çfarë autonomie spitalore mund të kemi në realitet, nëse nuk kemi menaxhim të spitaleve, kapacitet për të pasur autonomie menaxheriale?! Spitalet janë ndërmarrje në fund të ditës, nuk janë stalla ku veterinerët, ca llopë i shohin e ca jo, sipas humorit të tyre", - tha kryeministri. "Prandaj, - u shpreh ai, - unë dua që ju të mirëkuptoni kërkesën time që të jepni dorëheqjen, të gjithë drejtuesit e spitaleve rajonale e bashkiake. Ndërkohë, çdo ekip drejtues në çdo spital, përfshirë dhe 3 ekipet drejtuese të Tiranës, drejtuesve të cilëve unë nuk kam se si t'u them 'jepni dorëheqjen', sepse kanë dëshmuar se kanë sy, kanë veshë e kanë duar, do i nënshtrihen një konkursi publik, qëllimi i të cilit do të jetë që të ftohen të gjithë ata që kanë kapacitete dhe kompetenca menaxheriale, kushdo që mendon që i ka, përfshirë edhe kushdo ndër ju, nëse mendon se i ka, për të kandiduar për drejtimin e këtyre strukturave kaq të rëndësishme për shërbimin spitalor".

## Deputetja



**DHURATA ÇUPI**

"Kryeministri largon drejtorët që mbuluan mega-aferrat e superministrit të tij. Për katër vite, jo vetëm që shqiptarët nuk morën shëndetësi falas siç u propagandua me megafon, por shëndetësia shkoi në nivelin më të ulët të shërbimit për shqiptarët. Në kohën e qeverisjes demokratike, z. Rama mori shërbimin mjekësor në spitalin e Matit me kapacitete të plota personeli. Por tashmë ka katër vite që në këtë spital nuk ka personel mjekësor", - tha deputetja.



**Kreu i qeverisë mbledh Task-Forcën**

**"Operacion kombëtar, kontroll automjeteve të të fortëve"**

Kryeministri Edi Rama kërkoi dje nga drejtuesit e Policisë së Shtetit që të nisnin operacionin më të madh kombëtar kundër elementëve kriminalë që janë të lidhur me kultivimin e kanabisit. Në mbledhjen e Task-Forcës kundër kanabisit, kryeministri Edi Rama paralajmëroi nisjen e këtij operacioni me mbarimin e fluksit të turistëve. "Menjëherë me rënien e fluksit të turistëve të vihat në zbatim duke kontrolluar automjetet e këtyre personazheve. Të vihen para përgjegjësisë për të justifikuar vlerat marramendëse të automjeteve të tyre dhe aseteve të tyre, që të bëhet transparencë dhe pastaj të përgjigjen aty ku duhet, para prokurorisë dhe gjykatës", - tha Rama. Për kryeministrin, Policia e Shtetit ka informacion mbi këta elementë kriminalë që operacioni të dalë i suksesshëm dhe mesazhi për qytetarët duhet të jetë i qartë: "Për t'u dhënë një mesazh njerëzve të zakonshëm të këtij vendi se koha kur shteti ishte vetëm një alternativë e sigurisë së tyre dhe kur duhej ta kërkonin sigurinë duke paguar renta si biznese apo duke i nënshtruar këtyre elementëve, ka marrë fund një herë e përgjithmonë".

**PETRIT VASILI**

**"Kryeministri i paditur e çoi 270 vjet pas shëndetësinë"**

Kreu i Grupit Parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili tha dje, se "kryeministri i paditur e çoi 270 vjet pas shëndetësinë sepse: 1. Shpartalloi financimin e shëndetësisë me koncesionet. 2. Centralizoi në Ministrinë e Shëndetësisë të gjithë tenderat. 3. Centralizoi çdo emërim në Ministrinë e Shëndetësisë. 4. Dështoi totalisht me "shëndetësinë falas". Sipas Vasilit, Rama "shkatërroi çdo element të autonomisë spitalore me ndërgjegje të plotë. Tani fajin ia paskan drejtorët, që i zhveshi nga çdo kompetencë. Jo! Fajtori i vetëm është kryeministri, i cili rrinëoi shëndetësinë me anti-strategjinë të shkatërrimit gjithçka në emër të shëndetësisë falas".

**TRITAN SHEHU**

**"Rama ofendoi mjekët, i quajti shkak të dështimit"**

Drejtuasi i Departamentit të Shëndetësisë në PD, Tritan Shehu tha dje, se Rama nuk ka çfarë t'i bëjë gomarit dhe i bie samarit. Sipas tij, "gomari" është reforma në shëndetësi, ndërsa "samarit" janë këta drejtorë mjeranë të spitaleve që u shkarkuan dje, duke u etiketuar padrejtësisht si shkaktarët e dështimit, kur në të vërtetë janë veçse produkti i politikave dështuese të aplikuar prej vetë z.Rama". "Mjeranë, sepse asnjë nga ata nuk pati kurajën të rebelohet ndaj ofendimit që iu bë; ndoshta duke i quajtur si shkak i dështimit të një sistemi të tërë, iu duk vetja të rëndësishëm për një çast", - tha Shehu, duke e cilësuar takimin e Ramës si një vakë për atë reformë, të destinuar të vdiste që ditën që lindti.

Presidenti Ilir Meta dekretoi dje, dhënien e gradës madhore "Gjeneral Brigade", kolonelit Bardhyl Kollçaku. Sipas njoftimit për shtyp të presidencës, Presidenti Meta, në mbështetje të nenit 92, Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të pikës 3, germa a, të nenit 9, të ligjit 64/2014, "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimin e të komandimit të Forcave të Armatosura të RSH", i ndryshuar, me propozim të ministrit



Presidenti Ilir Meta

**Meta i dha gradën madhore kolonelit Bardhyl Kollçaku**

**Presidenti dekoron "Gjeneral Brigade" shefin e shërbimit sekret të Mbrojtjes**

të Mbrojtjes, ka dekretuar Kolonel Bardhyl Myrteza Kollçaku, me detyrë "Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteljencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes" në Ministrinë e Mbrojtjes, t'i jepet grada madhore "Gjeneral Brigade". Kolonel Bardhyl Myrteza Kollçaku ka lindur

më datë 05.06.1967, në Berat. Ka përfunduar studimet në Shkollën e Lartë të Bashkuar dhe është titulluar oficer aktiv në specialitetin "Zbulim", në vitin 1990. Gjatë karrierës së tij ushtarake ka kryer Kolegjin e Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen, në Shqipëri;

Kolegjin e Shtabeve të Bashkuara në SHBA; Kolegjin e Komandës dhe Shtabit, në SHBA; Kursin Themelor të Oficerit të Shtabit, në Shqipëri. Kolonel Kollçaku është vlerësuar me medalje të ndryshme për arritjet gjatë karrierës së tij ushtarake.

Sekretari i përgjithshëm, Braimllari: Rama po kontrollon drejtësinë

**Kolegji Zgjedhor: Mandati i LSI në Këshillin Bashkiak i takon Mezin**

*Kërkesa e kandidatës Veliasi u vlerësua e pabazuar në ligj*



Endrit Braimllari

Darina Tanushi

Kolegji Zgjedhor rrëzoi dje, kërkesën e kandidatës për Këshillin Bashkiak të LSI-së, Lindita Veliasi, pas ankimit të KQZ-së, që ia kaloi mandatin këshilltares bashkiake në listën e LSI Genta Mezini. "Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë, bazuar në nenin 158, pikën 1, germa b, dhe pikat 3 e 5 të Kodit Zgjedhor, vendosi rrëzimin e padisë të paditës Lindita Veliasi si të pabazuar në ligj. Ky vendim është i formës së prerë", thuhet në vendimin e lexuar nga gjyqtarët e Apelit. Genta Mezi mori mandatin ditën e hënë dhe u betua në Këshillin Bashkiak. Por Mezi u përjashtua nga LSI-ja pasi votoi së bashku me këshilltarët bashkiakë të PS-së për rritjen e çmimit të ujit të pijshëm, në Tiranë. Ndërkohë, pas vendimit të Kolegjit reagoi edhe LSI-ja, përmes Sekretarit të Përgjithshëm të saj, Endrit Braimllari. "Vendimi i Kolegjit Zgjedhor për këshilltarin bashkiak që i takon ligjërisht Lëvizjes Socialiste për Integrim vendosi që 19-ta është para 17-ës. Edi Rama tregoi edhe një herë qartazi që kërkon të ketë në kontroll çdo pushtet në Shqipëri, përfshirë pushtetin lokal dhe sistemin e drejtësisë, për të cilin ka shumë kohë që lufton që ta zotërojë në çdo mënyrë", - u shpreh Braimllari në reagimin



Këshilltarët e majtë duke votuar pro, gjatë një mbledhjeje të këshillit bashkiak të kryeqytetit

**PETRIT VASILI**

"Meqë ky shkollëpik që kemi në krye të qeverisë lexon përrallat e La Fontenit dhe meqenëse gjithë fajin që nuk i japin investime në Trieste, që jemi të 149-ët si mbështetësit më të dobët të të varfërve e mbështetësit më të mëdhenj të oligarkisë dhe që 60% e qytetarëve duan të ikin nga Shqipëria e ka administrata, ja ç'thotë La Fontenit në një përrallë..."

zyrtar: "Shqiptarët tani do të shikojnë se pas tepsisë, Edi Rama do të shtrohet këmbëkryq edhe në drejtësi. Tashmë regjimi i drogës, krimin dhe oligarkëve do të rendisë edhe listat e këshilltarëve dhe deputetëve. Vendimi i sotëm (dëshëm) tregon se i gjithë sistemi në Shqipëri është i kapur nga Edi Rama", - tha Braimllari. "Lëvizja Socialiste për Integrim është e vendosur në rrugën e saj për të bërë opozitë frontale ndaj këtij regjimi të neveritshëm, i cili po treg-

on çdo ditë e më shumë kapjen e çdo sistemi, duke përfshirë këtu edhe sistemin e drejtësisë. Kjo është politika e pashpresë e Edi Ramës, e cila po e çon Shqipërinë në udhëkryq, duke larguar çdo ditë e më shumë shqiptarët nga Shqipëria", thuhet në reagimin e LSI-së.

**KËSHILLI**

Gjithçka nisi ditën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak, ku dy prej këshilltarëve të LSI-së, Genta Mezini dhe Agim Kraja, u bashkuan me socialistët për rritjen e çmimit të ujit

të pijshëm. Genta Mezini mori pjesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak të Tiranës për herë të parë, atë ditë pasi zuri vendin e kryetares së LRI-së, Floida Kërpaçit, e cila u zgjodh deputete në zgjedhjet parlamentare të 25 qershorit. "Për sa u përket deklaratave të bëra nga LSI-ja për blerjen e votës sime, apo manipulimin e votës sime përkundër pazareve që vetëm një dëshpërim i thellë mund ta sajojë, ju bëj me dije që asgjë nuk është e vërtetë. Unë premtim që votën time, në Këshillin Bashkiak të Tiranës do ta përdor vetëm në të mirë të interesave të komunitetit. Jam e nderuar që më jepet mundësia të kontribuoj përkatërisht kryetarit të bashkisë, z. Erion Veliaj, dhe do bëj të pamundurën që të jap gjithë mundësitë e mia në shërbim të qytetarëve", - tha ajo, duke deklaruar shkëputjen nga LSI-ja. Pas kësaj, Lindita Veliasi, e 17-ta në listën e kandidatëve për këshilltarë të LSI-së, pretendoi se mandati i takon asaj dhe jo Mezin, i cila ishte e 19-ta. Por kjo u refuzua nga KQZ-ja, e cila ka miratuar kandidaturën e Mezinin si këshilltar. Por nga shkresat e Bashkisë së Tiranës drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, firmosur nga sekretari i përgjithshëm Behar Zeneli, i cili vjen nga radhët e LSI-së, thuhet qartë se Lindita Veliasi është punonjëse e Bashkisë së Tiranës dhe ka konflikte interesi, e për këtë arsye nuk mund ta marrë mandatin e këshilltares.

**Administratori i Zall-Herri largohet nga LSI**

**Arben Maloku: Kthehem te familja ime PS, mbështes "lali Erin"**

Administratori i njësisë administrative të Zall-Herri, Arben Maloku, i ardhur nga radhët e Lëvizjes Socialiste për Integrim, ka braktisur këtë parti duke u rikthyer siç shkruan ai, te "familja ime në PS". Në një postim të tij në rrjetin social "Facebook", Maloku u shpreh dje: "Rikthim te familja ime në PS! Prej dy vjetësh kam shërbyer si administrator i Zall-Herri, fryt i bashkëpunimit PS-LSI. Jam munduar çdo ditë të qëndroj pranë njerëzve dhe të mbaj rritmen e Kryetarit të Bashkisë Tiranë! Zall-Herri ka ndryshuar komplet këto dy vite". Herën e fundit Erion Veliaj dhe Ilir Meta shtrënguan duart me inaugurimet e reja, duke bërë thirrje për më shumë bashkëpunim në interes të komunitetit. Ish-të marrëdhënie e vërtetë!

Asnjë s'kandidonte në zgjedhjet parlamentare, dhe prapëseprapë i qëndruan fjalës që u dhanë banorëve për mbarimin e rrugëve brenda gjysmës së mandatit të Veliajt", - u shpreh Maloku. "Fatkeqësisht, pas ikjes së Ilir Metës nga LSI-ja, gjërat nuk janë si më parë! Kryetarit të bashkisë nuk iu dhanë votat për shkollat e reja dhe për ujin 24 orë nga LSI-ja, siç kishim rënë dakord. Një ditë pas betimit të presidentit, ku Veliaj ishte nga të paktët socialistë, ai u braktis nga LSI-ja për gjëra që kish bashkëpunim prej vitesh", - u shpreh ai. "Pa shkolla e pa ujë, nuk ka të ardhme Tirana. Sot po bëhet thirrje për opozitë kur ne jemi të gjithë ende në bashki. Largohet nënkryetarja e LSI-së, por rrinë drejtorët! Si mund të jemi edhe brenda edhe jashtë, edhe bashkë edhe kundër, edhe në pushtet edhe në opozitë?", tha ai, duke shtuar se do të mbështesë "lali Erin".



Arben Maloku

**NJOFTIM SHITJE ME ANKAND**  
 "PASURINË NR. 25/17, Z.K 1677, VOL. 2, FO. 185, SIP. TOTALE 1.080 M2, NGA TË CILAT, 500 M2 JANË SIP.TRUALLI, NDËRSA 334 M2 JANË NDËRTESE, NË ADRESËN: FSHATI FUSH-MILOUT, KURBIN, NË PRONËSI TË DEBITORIT Z. ADMIR HALLI.

**ÇMIMI 7.056.000 LEKË,** Data e zhvillimit të ankandit do jetë 25.08.2017.  
**ZYRA PËRMBARIMORË GJYQESORË PRIVATE "ILA ELEZI"**  
 Adresa: Blv. "Gjergj Fishta", Pallati "GORA", Kulla 1, Kati 2, Tirane.  
 Cel:0684026666 ; 0693262866

**Njoftim për shitje me ankand**  
 Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k do të zhvillojë ankandin e dytë për pasurinë e debitorit H Sallaku  
 - "Trulli" ndërtesë " me numur pasurie 222/49, Vol. 4, Fq. 201 ZK 1170, me sipërfaqe totale 3.808 m2 dhe 800 m2 është ndërtuesi njësi (400 janë të regjistruara në Hipotekë dhe 400 janë të pa regjistruara ) e ndodhur në Bërzhit, Tiranë.  
 Ankandi i pasurisë fillon me çmimin fillestar në masën 235.000 Euro  
 Ankandi qendron i hapur dhe do të zhvillohet në datë 21.08.2017 me orën 15:00, në Bulevard "Gjergj Fishta" Pall. i shoqërisë "Gora" Kulla 3, Kati 2, Zyra nr. 2.Tiranë  
 Olfertuesit duhet të tërheqin dokumentacionin të kontaktojnë me tel. 00355 67 20 82  
 543 ose e-mailit ilir\_dervishaj@yahoo.com si dhe WEB www.powerjustice-al.com

**Njoftim për shitje me ankand te dyte**  
 Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k do të zhvillojë ankandin e dytë për pasurinë e pale debitore E. Malaj dhe pale hipotekuese S. Malaj,  
 - "Apartment " me numur pasurie 29/159-12-14, e ndodhur ne Lagjen "Partizani " Vlore e regjistruar ne Z.V.R.PP Vlorë, e ndodhur ne Z. Kadastrale Nr. 8603, volumi 42, faqe 23.  
 Ankandi i pasurisë fillon me çmimin e ri fillestar në masën prej 3.528.000 Lekë  
 Ankandi qendron i hapur dhe do të zhvillohet në datë 23.08.2017, në orën 15:00 në Bulevard "Gjergj Fishta" Pall. i shoqërisë "Gora" Kulla 3, Kati 2, Zyra nr. 2.Tiranë  
 Olfertuesit duhet të tërheqin dokumentacionin të kontaktojnë me tel. 00355 67 20 82 543 ose e-mailit ilir\_dervishaj@yahoo.com si dhe WEB www.powerjustice-al.com



**Kategoritë që përfitojnë nga përjashtimi i detyrimeve doganore**

**Biznesi i vogël, ja si mund të importohen makineri pa tarifa doganore**

**B**izneset e vogla janë ndër kategoritë që përfitojnë nga përjashtimi i tarifave doganore për makineritë dhe pajisjet. Por, si për çdo kategori tjetër, ato duhet të plotësojnë një dokumentacion të ndryshëm nga kategoritë e tjera të biznesit. Nëpërmjet një udhëzimi të posaçëm, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave sqaron se biznesi i vogël, i cili do të importojë makineri prodhuese dhe pajisje në funksion të realizimit të kontratave të investimit të tyre duhet të

**PERFITIMI**

Përjashtim nga TVSH-ja në doganë përfitojnë tatimpaguesit, që importojnë makineri dhe pajisje në funksion të realizimit të kontratave të investimit me vlerë në ose mbi 50 000 000 lekë.

paraqesë në Degën Doganore përkatëse dokumentet e mëposhtme: një kërkesë me shkrim, të cilës kur kryhen veprime për herë të parë pranë autoriteteve doganore, i bashkëngjitet edhe një fotokopje e certifikatës së NUIS/NIPT-it. Vërtetimi nga

Drejtoria Rajonale Tatimore se importuesi është person i tatueshëm, që i nënshtrohet regjimit të biznesit (ndërmarrjeve) të vogla dhe ushtron aktivitet prodhues; kopje të ekstraktit të QKR-së; të dhëna për llojin dhe sasinë e makinerive prodhuese,

që do të importohen me kodet tarifore përkatëse dhe për periudhën e instalimit; deklaratë e personit të tatueshëm që makineria apo pajisja për të cilën kërkohet përjashtimi nuk është importuar për qëllime shitjeje. Sipas ligjit, përjashtim nga TVSH-ja në doganë përfitojnë tatimpaguesit që importojnë makineri dhe pajisje në funksion të realizimit të kontratave të investimit me vlerë në ose mbi 50 000 000 lekë; b) tatimpaguesit që importojnë makineri dhe

Fig.2 PBB për frymë sipas rajoneve statistikore nivel 3 vitit 2015 (000lekë)



pajisje në funksion të realizimit të kontratave të investimit në sektorin e punimit aktiv, pavarësisht nga vlera e investimit; c) tatimpaguesit (përfshirë fermerin) që importojnë makineri dhe pajisje në funksion të realizimit të kontratave të in-

vestimit në sektorin e agrobiznesit, pavarësisht nga vlera e investimit; c) tatimpaguesit, subjekt i takses së biznesit të vogël, të cilët importojnë makineri prodhuese në funksion të realizimit të kontratave të investimit të tyre.

Blerina Doracaj: Situata është dramatike dhe ka nevojë për përmirësime rrënjësore

# Hapet konkursi për drejtuesit e hipotekave

*Të përzgjedhurit në fund të gushtit, grup pune për përcaktimin e kriterëve*

Ornela Manjani

**Z**yrat e Regjistrimit të Pasurive në të gjithë vendin do të kenë në shtator drejtorë të rinj. Madje, i gjithë stafi i hipotekës do të riformatohet pas analizës së punës së gjithsecilit që punon në hipotekë. Tashmë janë hapur konkurset për drejtuesit e hipotekave. Deri në fund të muajit gusht do të jenë përzgjedhur të gjithë drejtues-



Blerina Doracaj, drejtoresha e Hipotekës


it e Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, përmes një procedure të hapur konkurrimi.

**GRUPET E PUNËS**

Së shpejti do të ngrihet një grup pune për përcaktimin e kriterëve të aplikuesve, ndërkohë që paralelisht do të nisë një proces verifikimi apo vetingu për punonjësit e hipotekave. Lajmi është dhënë nga Blerina Doracaj, kryeregjistruesja e Tiranës, e cila gjatë një deklaratë për mediat dha detajet e mëtejshme për konkursin e drejtuesve të hipotekave. "Shprehem se situata është dramatike dhe ka nevojë për përmirësime rrënjësore. Në të gjitha dëgjesat që ka bërë kryeministri, refreni ka qenë ZRPP. Për ecurinë e punës dhe situatën e çdo zyre është hartuar një informacion dhe i është paraqitur kryeministrit pa fshehur asgjë. Mbi ba-

zën e kësaj analize fillestare të situatës kam kërkuar që të gjithë drejtuesit e zyrave vendore të futen në një garë për të merituar nderin për t'u shërbyer qytetarëve. Regjistruesit do të zgjidhen kundrejt një procedure të hapur; e cila do të përmbyllet në fund të muajit gusht. Për këtë do të ngrihet një grup pune për përcaktimin e kriterëve të rrepta dhe gushtesisht teknike për aplikuesit për regjistruesit në të gjitha zyrat vendore", tha Doracaj.

Sa i takon procesit të vetingut, gjatë kësaj deklarate, Doracaj pohoi se paralelisht me analizën e punës do të nisë edhe zbatimin e tij. "Paralelisht me hapjen e konkursit për regjistruesit do të nisë edhe një proces verifikimi apo vetingu për të gjithë punonjësit e zyrave të regjistrimit nga i pari tek i fundit. Për çdo rast që do të konstatohet shkelje ligji do të procedohet me kallëzime penale dhe për çdo rast të shkeljes administrative do të bëhet largimi nga puna i këtyre punonjësve".



**Zona e lirë ekonomike në Spitalë**

**MZHETS shpall fituesin e tenderit, oferta 39 mln euro**

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes ka shpallur fituesin e tenderit për ndërtimin, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e zonës së lirë ekonomike në Spitalë. Përmes njoftimit të publikuar në faqen e Agjencisë së Prokurimit Publik bëhet me dije se fitues është bashkimi i përkohshëm i 3 operatorëve: "Pelikan" shpk, "The Best Construction" shpk dhe "Vëllezërit Hysa" shpk. Oferta e tyre është vlerësuar me 71.2 pikë, duke lënë pas ofertën e "Edil-AL-IT", e cila arriti të marrë 70.6 pikë. Sipas projektit të paraqitur, bashkimi i operatorëve parashikon ndërtimin e një fabrike për pasurimin e ferro-kromit, ndërsa vlera e ofertës është rreth 39 milionë euro. Sipërfaqja e zonës që do të ndërtohet dhe zhvillohet është 101.22 hektarë, për një periudhë 99 vjet. Ndërkaq, sipas njoftimit të APP, konsorciumi i operatorëve do të duhet të paraqesë pranë Ministrisë të Zhvillimit Ekonomik sigurimin e kontratës sipas formës së kërkuar në Dokumentin Standard të Procedurës Konkurruese si dhe dokumentin bankar, që vërteton pagesën e kryer për shpenzimet e publikimit dhe shpenzimet e konsulentëve të specializuar. Njoftimi i renditjes së fituesit të këtij tenderi u bë fillimisht në datën 5 korrik, por u kundërshtua nga ofertuesi i dytë. Kjo ishte edhe arsyeja përse kompania "EDIL AL-IT" depozitoi ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, por përmes një shkresë që mban datën 17.07.2017, operatori u njoftua se ankesa nuk u pranua. Spitala u shpall zonë e lirë ekonomike në maj të këtij viti, kohë kur ministria e Ekonomisë, Milva Ikononi bëri me dije se po shqyrtoheshin 2 oferta për zhvillimin e saj. Sipas kreut të Ekonomisë, përfitimi më i madh nga zona është rritja e produktivitetit.

**Raporti i INSTAT për të ardhurat për frymë në të gjithë vendin**

**Qytetet më të pasura dhe më të varfra në Shqipëri**

Personat që banojnë në Tiranë kanë mesatarisht të ardhur rat më të larta për frymë në Shqipëri, sipas raportit të fundit të INSTAT për Prodhimin e Brendshëm Bruto, sipas rajoneve statistikore. Tiranë kishte të ardhura për frymë prej 679 mijë lekë në vitin 2015 dhe pati një rritje me 5,5%, krahasuar me vitin 2014. PBB për frymë e këtij qarku është 37,0% mbi mesataren e vendit. Më pas renditen qarku Fier me 550 mijë lekë, duke shënuar një rënie prej 9,6%, ndaj vitit 2014. PBB për frymë e këtij qarku është 11,0% mbi mesataren e vendit. Pas Fierit renditen Gjirokastra, Durrësi, Vlora, Berati, Korça. Qyteti më i varfër është Kukësi, me rreth 319 mijë lekë, duke shënuar një rënie me 2,2%, krahasuar me vitin 2014. PBB për frymë e këtij qarku është 35,7% nën mesataren e vendit. Më pas, me PBB-në për frymë më të ulët renditet qarku Elbasan me rreth 351 mijë lekë duke shënuar një rënie me 0,5% ndaj vitit 2014. PBB për frymë e këtij qarku është 29,2%, nën mesataren e vendit. Për gjithë Shqipërinë, në vitin 2015, niveli i PBB-së për frymë është rreth 496 mijë lekë. Krahasuar me vitin 2014, PBB për frymë u rrit me 2,63%. Në rajonin statistikor Qendër, PBB për frymë është 679 mijë lekë dhe pati një rritje me 4,8%, krahasuar me vitin 2014. PBB për frymë e këtij rajoni rezultoi 20,1% mbi mesataren e vendit. Në rajonin statistikor Veri, PBB për frymë është 404 mijë lekë, duke shënuar një rritje me 5,9%, krahasuar me vitin 2014. PBB për frymë e këtij rajoni është 18,5% nën mesataren e vendit. Në rajonin statistikor Jug, PBB për frymë është 457 mijë lekë, duke shënuar një rënie me 3,3%, krahasuar me vitin 2014. PBB për frymë e këtij rajoni është 7,8% nën mesataren e vendit.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**DHOMA KOMETARE E PËRMBARUESVE GJYEQSORË PRIVATE**  
**SHOQËRIA PËRMBARIMORE "EXECUTORES LITUM" (EXC LIT) sh.p.k**

**Shoqëria Përmbarimore "Executores Litium" sh.p.k**  
 do të zhvillojë ankandin për pasurinë e paluajtshme :

1-Arë me sipërfaqe 13,000 m2, ndodhur në Fushë-Prezë Tiranë, regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, Zona kadastrale 1669, nr.pasurie 38/10, vol 5, faqe 202, pronë e z. Behar Ibrahim, z. Eduart Ibrahim, z.Arben Ibrahim, z. Flamur Ibrahim. Cmimi me të cilin do të fillojë ankandi është në vlerën 156,000 euro

2- Arë me sipërfaqe 8,200 m2, ndodhur në Fushë-Prezë Tiranë, regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, Zona kadastrale 1669, nr.pasurie 6/4, vol 4, faqe 34, pronë e z. Fatmir Kaziu Cmimi me të cilin do të fillojë ankandi është në vlerën 184,000 euro

Ankandi do të zhvillohet në datë **15.08.2017 ora 16:00**, në zyrën përmbarimore "Executores Litium" sh.p.k, me adresë Blv "Zhan Dark", Kulla 1 Teknopjekt, shk 1, kati 4, ap 10, Tiranë

Bie ndjeshëm kredia për ekonominë në 2017-n, bankat fshijnë masivisht huat në valutë

Ornela Manjani


# Bizneset dhe konsumatorët "heqin dorë" nga huamarrja

Vlera e kredisë është 1.6% më e ulët se një vit më parë


Kredia për ekonominë rezultoi në rënie për gjashtëmuajorin e parë të këtij viti. Sipas statistikave të Bankës së Shqipërisë, në fund të qershorit portofoli total i kredisë zbriti në vlerën e 543.5 miliardë lekëve, me një rënie të mëtejshme prej afro 1 miliard lekësh krahasuar me majin. Vlera e kredisë është 1.6% më e ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Prej disa muajsh, Banka e Shqipërisë po shpreh optimizime për ritmet e kreditimit dhe në fakt, vlera e raportuar e kredive të reja këtë vit është më e lartë. Vetëm për qershorin, kredia e re ishte 26 miliardë lekë, pesë miliardë lekë më shumë krahasuar me qershorin e vitit të kaluar.

**RAPORTI**

Huaja për ekonominë, që është një tregues i financimeve që marrin bizneset për të investuar ose qarkulluar kapitalin dhe individët për të blerë pasuri të paluajtshme apo produkte konsumi ka shënuar një rënie të fortë në muajin qershor. Sipas statistikave të Bankës së Shqipërisë, stoku i huas për ekonominë zbriti në 543.5 miliardë lekë, duke arritur në nivelin më të ulët që nga janari i vitit 2016. Vetëm në qershor, stoku i huas u reduktua me 955 milionë lekë në raport me muajin e mëparshëm, pasi ishte reduktuar ndjeshëm edhe në janar dhe prill. Në krahasim me dhjetorin 2016, stoku i huas për ekonominë ka rënë me 0.7%. Me bazë vjetore (qershor 2017/qershor 2016), kredia e dhënë për ekonominë është reduktuar me 1.6%. Me bazë vjetore, e gjithë rënia është ndikuar nga tkurrja e stokut të huas, dhënë korporatave jofinanciare në valutë, pra kryesisht huaja e dhënë në euro për bizneset, stoku i të cilës



Totali i kredisë, jan 2013-qershor 2015



ka rënë me 26 miliardë lekë në raport me qershorin 2016, nga 8.9 miliardë lekë që ka rënë stoku në total i huas për të njëjtën periudhë. **FSHIRJA E KREDIVE** Sistemi bankar është përfshirë në një proces të fshirjes së kredive që janë më shumë se tre vjet vonesë, që janë reduktuar kryesisht në valutë. Kjo fshirje u reflektua edhe në uljen e treguesit të kredisë me

probleme, që zbriti në 15.86% në muajin maj, larg nga niveli rekord i afër 25%, që arriti në mesin e vitit 2014. **INDIVIDËT** Rritjen më të lartë në vlerë absolute vitin e fundit e ka shënuar kredia për individë, me rreth 8.8 miliardë lekë më shumë, apo zgjerim 8.7%, në raport me qershorin 2016. Kredia për bizneset në lekë ka shënuar

një rritje më të moderuar me 6.4%. Banka e Shqipërisë njoftoi në vërtetimin e fundit se bankat vijuan të mbanin të shtrënguara standardet e kreditimit për bizneset, ndërsa i kanë liruar për individët. Këta të fundit kanë rezultuar kredimarrës më të mirë, teksa përgjindja e kredive të tyre me probleme është gati tri herë më e ulët se e bizneseve.

**NË FUND TË QERSHORIT, JASHTË SISTEMIT BANKAR QARKULLONIN 250 MLD LEKË**

Zgjedhjet, 44 milionë euro ikën jashtë bankave në mars-qershor



Paraja që qarkullon jashtë sistemit bankar ka arritur në një nivel rekord në qershor, sipas statistikave të publikuara sot nga Banka e Shqipërisë. Në fund të qershorit, jashtë sistemit bankar qarkullonin 250 miliardë lekë, apo rreth 1.8 miliardë euro, niveli më i lartë rekord në vite. Vetëm gjatë muajit qershor kemi një rritje me 3.8 miliardë lekë, apo rreth 28 miliardë euro më shumë, që kanë qarkulluar në treg. Edhe në prill ky tregues ishte rritur me 13 milionë euro, ndërsa në maj nuk u konstatua rritje e ndjeshme këtij treguesi. Për gjithë periudhën mars-qershor, paraja jashtë sistemit bankar u rrit me rreth 44 milionë euro. Teksa ka një rritje sezonale të parasë jashtë bankave në dhjetor dhe gusht të çdo viti, e lidhur me flukset e emigrantëve, kjo rritje në qershor është e lidhur me shpenzimet e larta përpara zgjedhjeve, një tendencë kjo që është konstatuar në çdo fushatë parazgjedhore. "P.sh. në maj-qershor 2015, para zgjedhjeve vendore, ky tregues u rrit me gati 10 miliardë lekë. Në prill-maj 2013, për zgjedhjet e përgjithshme paraja jashtë bankave shënoi rritje me rreth 9 miliardë lekë, sipas statistikave të Bankës së Shqipërisë. Në prill-qershor 2009, ky indikator u zgjerua me rreth 6.6 miliardë lekë", - thuhet në analizën e "Monitor". Rritja e parasë jashtë bankave duket se ka krijuar likuiditet të bollshëm jashtë kanaleve bankare. Qarkullimi i parave jashtë bankave është nxitur vitet e fundit edhe nga politika lehtësuese që ka ndjekur Banka e Shqipërisë. Ulja e normës bazë të interesit në 1.25% është reflektuar në uljen e interesave të depozitave në lekë. Nëse indeksojmë interesin e depozitave në banka me inflacionin e muajit, interesi real është në negativ me -1%. Banka e Shqipërisë ka njoftuar së fundmi për rigjallërimin e fenomenit të huadhenies informale. Ka një lidhje empirike ndërmjet rritjes së parasë që qarkullon jashtë bankave dhe fenomenit të fajdeve. Edhe në vitin 2015, kur financimet me kontrata huaje nga noterët u rritën jashtë normales, pati një rritje jo të zakonit të qarkullimit të parasë jashtë kanaleve bankave.

Tregu i gazit/ Gjybiten 72 subjekte, shkelën kushtet e sigurisë

## ISHTI, konsumatorëve: Merrni vetëm bombola të kolauduara



aturave të larta dhe sezonit turistik, ISHTI ka intensifikuar kontrollin, ndërsa u kërkon të gjithë opera-

torëve ekonomikë të mos shfrytëzojnë pajisje nën presion pa i certifikuar teknikisht dhe pa i pajisur me dokumentacionin teknik. ISHTI u bën thirrje të gjitha shoqërive që tregtojnë me shumicë gaz të lëngshëm natyror të mos furnizojnë asnjë operator ekonomik që ka të instaluar pajisje nën presion, nëse këto pajisje nuk janë të regjistruara. Konsumatorët familjarë duhet të jenë të kujdesshëm dhe të vëmendshëm kur marrin bombolat e gazit, pasi duhet të sigurohen paraprakisht se bombolat të jenë të kolauduara, çka do të thotë që të jenë të certifikuara me të gjithë elementët teknikë të sigurisë.

Mungesa e kushteve të sigurisë në tregtimin e gazit ka çuar në ndëshkimin e 72 subjekteve. Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial ka ushtruar kontrollin në pikat e tregtim-it dhe për shkak të shkeljes së kushteve të sigurisë ka gjybitur me 50 mijë deri në 500 mijë lekë 72 operatorë. Masat janë marrë që nga fillimi i vitit dhe deri tani. Në total janë kontrolluar 2300 pajisje nën presion, ndërsa janë mbajtur mbi 1400 akte inspektimi si dhe mbi 200 urdhra ndalesë. Për shkak të temper-

**SHPLLJE ANKANDI**

Shoqëria përmbytore gjyqësore private "ARB" Sh.p.k. zhvillon Ankanid e Dytë për shfajtim e kundër të detyrës në pasurinë e kaqitme. Shoqëria "COMPROSER" Sh.p.k. me NUIS (NPT) K72453007A me adresë në: Rruga "Nikolla Leka", Nr. 134, Tiranë, në pronësi të detyrës Suzana Mulla (Myfi) Shota dhe Mark Gjergj Shota, respektivisht Suzana Mulla (Myfi) Shota ortak me 80% të kapitalit në shoqërinë "COMPROSER" Sh.p.k. dhe Mark Gjergj Shota ortak me 20%, të kapitalit në shoqërinë "COMPROSER" Sh.p.k. Gjenerali filluar me të cilin fillon ankandit i dytë është 12.814.542.72 (dymbëdhjetë milion e tetëqind e katërmijëdhjetë mijë e pesëqind e dyzet e dy pikë shtatëdhjetë e dy) Lekë. Ankanid do të zhvillohet datë 02.08.2017, Ora 16:00, në adresën: Oendra e Zhvillimit të Ankanideve Publike Përmbytore ("ZHPAP"), me adresë në: Rruga "Nikolla Jorga", Nëntësra Nr. 9, Kat 2, pranë Dhomës Kombëtare të Përmbytësve Gjyqësorë Privatë, Tiranë. Për informacion të mëtejshëm kontaktimi me shoqërinë përmbytore gjyqësore private "ARB" Sh.p.k. me adresë: Rruga "Fatmir Haxhiu", Pall.: 21, Shk. 3, Ap. 3, Tiranë; tel: 042.252888; ose në adresën e email-it: info@arb.al





Kreu i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj gjatë prezantimit të projektit

**Prezantohen tri projektet e arkitektëve të Harvardit**

**Erion Veliaj: Parku Qendror do ecë paralelisht me Bulevardin e Ri**

me zhvillimin e idesë për krijimin e Parkut Qendror të Bulevardi i Ri. Veliaj theksoi se ky projekt bën të mundur të ecet në të njëjtën kohë si me ndërtimin e pjesës së dytë të Bulevardit të Ri, ashtu edhe në krijimin e parkut si një hapësirë çlodhëse dhe argëtuese. Sa i përket projektit për transformimin e Kombinatit, Veliaj theksoi se puna do të nisë nga qendra e tij për ta kthyer atë në një nga poliçendrat e Tiranës, ashtu siç e parashikon Planin i Përgjithshëm Vendor.

produkt të preکشëm për kryeqytetin. Bashkia e Tiranës do të mbështesë tri projektet e para të hartuara nga arkitektët e Universitetit të Harvardit, të cilët në bashkëpunim me studentët të shqiptarë kanë ideuar zhvillimin e Parkut Qendror të Bulevardit të Ri, poliçendrën e Kombinatit dhe fasadat e qytetit. Kreu i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, falënderoi arkitektët që punuan për realizimin e

projekteve dhe siguroi se ato do të kalojnë në fazën e financimit dhe zbatimit. "Angazhimi ynë është që t'i kthejmë këto ëndrra të bukura në projekte. Bashkia e Tiranës do të vendosë në dispozicion buxhetin dhe stafin e nevojshëm për realizimin e të tria projekteve. Pra, edhe projektin e Parkut Qendror të Bulevardi i Ri, edhe projektin e ndërhyrjeve në Kombinat, edhe projektin e artit publik i fasa-

dave, që shkon në fakt edhe me imazhin dhe reputacionin që ka Tirana, si qytet që provokon me art dhe ngjyra. Kështu që, mezi pres që këto projekte konkrete t'i buxhetojmë këtë vit dhe vitin tjetër të nisim nga puna", tha kryebashkiaku Veliaj gjatë takimit që u organizua në Qendrën COD për prezantimin e projekteve. Duke u ndalur në secilin prej punimeve, ai theksoi se projektin i parë ka të bëjë

Bashkëpunimi mes Bashkisë së Tiranës, Universitetit të Harvardit dhe studentëve shqiptarë të Arkitekturës do të shndërrohet shumë shpejt në një

Djegia e plehrave, qytetarët: Po vdesim nga helmi që lëshohet përreth nesh

**Protestojnë kamzalinjtë, Mziu: Qeveria nuk na jep leje mjedisore**

*"Bisedoj vetëm me banorët e mi, jo me të Tiranës që janë në PS"*

Banorët e Kamzës kanë protestuar sërish kundra djegies së mbeturinave në Kamëz, ndërsa kërkuar takim me kryetarin e tyre për zgjidhjen e situatës. Që prej disa ditësh, ata jetojnë mes helmeve që lëshon asgjësimi i plehrave mes të cilave, po sipas tyre ka, edhe mbeturina spitalore e ushtarake. "Po vdesim". Kjo është fjalja që thonë shumica e tyre, ndërsa kush ka mundur, ka larguar fëmijët nga shtëpitë. Xhelal Mziu nuk ka pranuar t'i takojë të gjithë banorët, të cilët u mbledhën para Bashkisë së Kamzës me pretendimin se organizatori kryesor i protestës ishte përfaqësues i PS-së dhe me banim në Zall-Herr, njësi administrative e Tiranës, megjithatë ka takuar ambientalistin Sazan Guri, që ka dalë në krah të banorëve të Kamzës. Sipas kryetarit, Mziu pika e vendëpozitimit të mbetjeve ku aktualisht ato hidhen është brenda normave teknike e ligjore, e miratuar, ku akt miratimi i rinfreskuar i lejes së mjedisit të tipit C është bërë nga Agjencia Rajonale e Mjedisit më 12.8.2016, me nr. prot. 724 dhe nr. identifikimi të lejes 724 dhe e konfirmuar nga Ministria e Mjedisit më 26.10.2016 me nr. prot. 6976 nr. identifikimi 193. Pra, zona ku deri më tani hidheshin dhe hidhen mbetjet urbane të Bashkisë Kamëz është brenda të gjitha normave, sepse kjo zonë nuk ishte e populluar deri në kohën në të cilën është bërë



**XHELAL MZIU**

Zona ku deri më tani hidheshin dhe hidhen mbetjet urbane të Bashkisë Kamëz është brenda të gjitha normave, sepse kjo zonë nuk ishte e populluar deri në kohën në të cilën është bërë miratimi si vendëpozitim i mbetjeve urbane të planifikuar për qytetarët e kësaj njësie administrative, duke qenë një pikë grumbullimi prej 20 vitesh.

miratimi si vendëpozitim i mbetjeve urbane të planifikuar për qytetarët e kësaj njësie administrative, duke qenë një pikë grumbullimi prej 20 vitesh. Në këto kushte, ai shprehet se ka kërkuar ndërtimin e një landfilli, por askush s'ia ka vënë veshin. Kryetari i Bashkisë së Kamzës, Xhelal Mziu shprehet se bashkia e këshilli bashkiak kanë

miratuar krijimin e një pike tjetër të mbledhjes së mbeturinave në Valias, por Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë i refuzon lejen e mjedisit Bashkisë Kamëz, duke sjellë për pasojë këtë situatë. Ndërkaq, kamzalinjtë shprehen se do të vazhdojnë protestat deri në zgjidhjen e kësaj situatë, sepse realisht jeta e tyre është në rrezik.

**BANKERS PETROLEUM ALBANIA L.T.D**

**NJOFTIM PËR VENDE TË LIRA PUNE**

Bankers Petroleum Albania Ltd. (Bankers) është një kompani e Geo-Jade Petroleum Corporation, një kompani ndërkombëtare e kërkimit dhe prodhimit të naftës e angazhuar në zhvillimin e përgjegjshëm të aseteve të saj të naftës të nivelit botëror. Me qendër teknike në Calgary, Alberta, dhe zyrë qendrore në Pekin, Bankers është një njësi e pavarur biznesi me aktivitet në Shqipëri dhe Evropën Lindore. Gjatë 13 viteve aktivitet në Shqipëri, Bankers ka ndërtuar një ekip teknik me përvojë, i cili përdor teknika të nivelit të lartë në nxjerrjen e naftës së rëndë dhe zhvillimin e Patos-Marinzës, vendburimi më i madh në tokë i naftës në Evropë. Në Bankers, ne punojmë fort për ta pozicionuar veten si një partner i zgjedhur për Shqipërinë për të operuar në vendburimin më të madh të vendit. Bankers ka bërë të mundur që duke përdorur ekspertizën e tij, të prodhojë sot më shumë se në 85 vjet histori të vendburimit. Gjatë dhjetë viteve të fundit Bankers është rritur për të qenë investitori më i madh direkt, tatimpaguesi dhe punëdhënësi më i madh në Shqipëri dhe Bankers do të vazhdojë të bëjë investime të rëndësishme në zonën naftëmbajtëse të saj në vitet që do të vijjnë dhe ka objektivat të larta lidhur me rritjen e rezervave, prodhimin dhe shitjet.

Për të arritur objektivat tona, ne jemi vazhdimisht duke kërkuar të punësojmë njerëz të pershatsuem e të kualifikuar, të cilët demonstronjë cilësi të tilla si entuziazmi, iniciativë, punë në grup, aftësi drejtuese etj. Bankers ofron një paketë shpërblymje konkurruese krahasuar me tregun e një kulturë të vlerësimit të performancës. Bankers udhëhiqet nga parimi i mundësive të barabarta në punësim duke ofruar e promovuar një mjedis të ndershëm dhe jodiskriminues.

Bankers është duke kërkuar kandidatë të kualifikuar për të plotësuar dy vende vakant në pozicionin **Teknik Instrumentash**.

**Kërkesat për Pozicionin:**

- Diplomë Universitare në Inxhinieri Elektrike, Elektronike ose Megatronike;
- Preferohet eksperiencë në instrumente, njohuri elektrike dhe/ose elektronike;
- Preferohet eksperiencë në konfigurimin dhe programimin e sistemeve SCADA dhe PLC's;
- Njohuri të mirë e gjuhës Angleze (në të shkruar dhe në folur);
- Aftësi shumë të mira kompjuterike. Njohuri në programim, instrumente, kontrollet elektrike;
- Planifikim i mirë, aftësi raportuese dhe organizative;
- Komunikim të shkëlqyer dhe aftësi ndërpersonale;
- Aftësi dhe dëshirë për të mësuar dhe punuar në skuadër;
- Aftësi për të përcaktuar prioritetet, përbushur afatet, dhe për t'u përqendruar në informacione të detajuara;
- Leje drejtimi automjeti;

Të gjithë aplikantët duhet të dërgojnë një Curriculum Vitae në Anglisht në një zarf të mbyllur në adresën e mëposhtme:  
**Rr. "Shën Leonardo Murialdo", Nd. 24, Sheq i Madh, 9304, Fier, Albania**

**Për: Departamentin e Burimeve Njerëzore**

ose me E-mail tek: [humanresources@bankerspetroleum.com](mailto:humanresources@bankerspetroleum.com)

Afati i fundit për të dorëzuar aplikimet është **20 Gusht, 2017**. Të gjitha aplikimet do të merren në konsideratë dhe do të u kthehet përgjigje brenda një afati të shkurtër kohor.

**Ju lutem duhet të jeni në dijeni për sa më poshtë:**

- Vetëm kandidatët e përzgjedhur për intervistë do të kontaktohen.
- Të gjithë kandidatët do të marrin një SMS ose e-mail që konfirmim marrjen e aplikimit të tyre.
- Të gjitha aplikimet do të mbahen në dosje për dy vjet nga data e marrjes.

Policia arreston autorin e krimit, Pjetër Pjetri: Po, unë e vrava, armën e hodha kur po më ndiqnit

Senad Nikshiqi

SHKODËR

Një konflikt për kanal vaditës i ka kushuar jetën një 50-vjeçari nga ish-shati Logegaj i Vaut të Dejës në Shkodër. Mhill Pali është qëlluar për vdekje me kallashnikov nga bashkëfshatari i tij Pjetër Pjetri, i cili ka përfunduar në pranga. Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së Qarkut të Shkodrës dje bënë me dije se ngjarja e rëndë ka ndodhur mesditën e djeshme, në malin e Cukalit, larg nga vendi ku banonin dy shtetasit e konfliktuar. Mësohet se fillimisht 50-vjeçari është plagosur rëndë, ndërsa ka humbur jetën pas disa orësh në spitalin rajonal të Shkodrës. Pas sinjalizimit për vrasjen, blutë kanë shkuar në vendngjarje dhe kanë nisur hetimin. Burimet e mësipërme pohuan se autori i krimit akuzohet për veprat penale "Vrasje" dhe "Armëmbajtje pa leje".

VRASJA

Rreth orës 12:30, Mhill Pali ka mbetur i plagosur rëndë. Menjëherë drejt vendit të ngjarjes është nisur një autoambulancë, për të bërë transportimin e tij drejt spitalit rajonal të Shkodrës. Transportimi ka pasur vështirësi, për shkak të terrenit të thyer malor dhe largësisë nga Shkodra deri në malin e Cukalit. Problem është bërë edhe rruga e am-

# Konflikti për kanal vaditës, vritet 50-vjeçari

Viktima Mhill Pali u qëllua nga bashkëfshatari i tij me kallashnikov



Policia e Shkodrës

ortizuar në një pjesë të konsiderueshme të udhëtimit. Gjatë transportimit, 50-vjeçari që ndodhej në gjendje të rëndë shëndetësore ka pasur vetëm një plumb në gjoks, por ka humbur sasi të konsiderueshme gjaku. Pavarësisht kujdesit të mjekëve, Mhill Pali nuk ka

arritur që t'i bëjë ballë plagës së marrë. Drejt vendit të ngjarjes janë nisur edhe forcat e policisë, për të bërë hetimet mbi këtë plagosje me pasojë vdekjen. Sipas burimeve policore, viktima punonte në malin e Cukalit me një prej firmave private për të prerë lëndë

drusore. Ndërsa mësohet se prej kohësh familja e tij dhe familja e autorit të krimit, Pjetër Pjetri kishin pasur konflikte për një kanal vaditës. Ata kishin debatuar herë pas here se kujt i takonte kanali, por edhe ia kishin bllokuar vaditjen disa herë njëri-tjetrit, për të

ardhur deri te ngjarja e rëndë. Sipas hetuesve të çështjes, dje, Pjetri ka shkuar në malin e Cukalit, vendin ku punonte 50-vjeçari. Pas një debati mes tyre, Pjetri ka qëlluar me automatik kallashnikov (me një plumb) Mhill Palin, duke e lënë të plagosur rëndë.

ARRESTIMI

Pas kryerjes së veprimeve hetimore paraprake, policia e Shkodrës ka identifikuar autorin e dyshuar të plagosjes me pasojë vdekjen e 50-vjeçarit dhe ka bërë të mundur kapjen e tij. Pas arrestimit, shtetasi Pjetër Pjetri ka pranuar autorësinë e plagosjes me pasojë vdekjen, duke thënë se është ai që e ka qëlluar, dhe duke treguar se shkak është bërë kanali vaditës. Policia ende nuk ka gjetur armën e krimit, për shkak se autori e ka hedhur gjatë kohës kur ka qenë në ndjekje nga uniformat blu.



Abuzoi me detyrën, prangoset ish-punonjësi i Bankës së Shqipërisë

POGRADEÇ - Policia e Pogradecit ka arrestuar ish-punonjësin e Thesarit në Bankën e Shqipërisë, Emiljano Lamçe, i dënuar me 1 vit e 4 muaj burg për veprën penale "Shpërdorim i detyrës". Shërbimet e Policisë në Pikën e Kalimit Kufitar Tushemisht, në dalje të Republikës së Shqipërisë, bënë ndalimin e shtetasit në kërkim Emiljano Lamçe, 35 vjeç, banues në Tiranë. Ndalimi i tij u bë pasi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendim nr. 1819, datë 27.05.2015 (lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me datë 22.09.2016), e ka dënuar këtë shtetas me 1 vit e 4 muaj burg për veprën penale "Shpërdorim i detyrës", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Veprimet e mëtejshme procedurale lidhur me këtë rast do të kryhen nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, thuhet në njoftimin zyrtar të policisë.

## Babai i 32-vjeçares në "News24": Vajzës i ngritën kurth

Gruaja që u filmua me dashnorin: Turp të ketë im shoq, prej mishi e gjaku jam edhe unë!

TIRANË - Pas videoskandalit në Koplik të publikuar në emisionin "Me Zemër të Hapur" në "News24", ku një grua u kap në shtrat me të dashurin në prani të fëmijëve, vetë Lule Nacaj, protagonistja e videos, në një lidhje telefonike me emisionin, ka treguar versionin e saj të ngjarjes. Sipas saj, videoja është e montuar nga njerëzit e bashkëshortit të saj dhe është bërë për të hedhur balte mbi të.

Lule Nacaj, gjithashtu zbuloi se bashkëshorti i saj bën një jetë të dyfishtë, pasi ka 4 vite që është i martuar në Amerikë.

E pyetur nga gazetaria Evis Ahmeti nëse fëmijët kanë qenë të pranishëm në dhomë gjatë kohës që ajo ishte me të dashurin, Lulja e ka mohuar një gjë të tillë. "Kjo video është publikuar nga familjarët e tij, për të blerë burrin tim me lekë. Fëmijët i kam rritur unë, burri im është i martuar në Amerikë. Videoja është modifikuar,



Babai i 32-vjeçares në emisionin "Me Zemër të Hapur" në "News24"

është blerë me pare. Jam motër e 6 vëllezërve. Mos u mashtroni! Jam grua e dhunuar dhe e shtypur. Fëmijët e mi janë terrorizuar. Turp të ketë burri im! Fëmijët e mi kanë qenë në gjumë, nuk dinë asgjë se çfarë kanë bërë këta familjarë. Ai më la mua në dorë të dhëndrit, të kunatave, e duke i mësuar fëmijët të thonë fjalët më të këqija për

mua. Fëmijët nuk kanë qenë në krevat, nuk kanë qenë në të njëjtën dhomë me mua. Fëmijët e mi nuk kanë parë gjë. Nuk i kam dhunuar unë fëmijët, por i kanë dhunuar ata familjarët", - rrëfeu Lulja. E pyetur se çfarë e shtypur drejt këtyre veprimeve, 32-vjeçarja akuzoi bashkëshortin e saj, i cili prej katër vitesh i ka harruar. "Jam një grua e dhunuar, më kanë torturuar gjithë kohës, ndërsa ai është burrë me tri gra. E treta grua jeton me të në Amerikë. Prej mishi e gjaku jam edhe unë. I bëj thirrje Perit të mos blihet me para". Ndërkaq, dje nga Vermoshi i largët ka zbritur drejt Tiranës, babai i nuses së familjes Nacaj. Ai deklaroi se ndihet keq nga gjithçka e transmetuar. Ndërsa, tha se familja e dhëndrit e ka regjistru-

ar videoën para 7 muajsh dhe e kanë hedhur në rrjetet sociale.

Si ndiheni, zoti Marash?

Me keqardhje dal në këtë studio për këso gjanash. Që kur kanë lindur ata fëmijë, përgjegjës për ta kam qenë unë ekonomikisht. Babai ishte këtu, por nuk kishte punë. Kur iku në Amerikë, i thashë 'ti po ikën, por nusja është e re'. Ky iku si gjithë shqiptarët, por gjërat iu përdrohen e s'mundi me e marrë familjen.

Pse mendoni që është ngjitur një skenar? Kjo video, qarkullon në zonën tuaj?

Po, e kanë futur edhe në rrjetet sociale, jam shumë i indinjuar. I është ngritur skenar sime bje.

Pse është te zgjatur ky proces gjyqësor?

Unë nuk e di, por nuk është dhënë urdhër mbrojtjeje, kjo video nuk do dilte në mbrojtje.

Çfarë kërkoni nga drejtësia?

Kërkoj të m'i lënë nipërit rehat, kaq dua unë.

## Psikologja: Si më kërcënonte me mesazhe burri i Lule Nacajt

TIRANË - Psikologja Mimoza Gjurmaj që dha miratimin që fëmijët e mitur të Lule dhe Peri Nacajt të qëndrojnë me nënën, tha dje se është kërcënuar. Në një komunikim telefonik në studion e emisionit "Me Zemër të Hapur", Gjurmaj deklaroi ndër të tjera se ka marrë kërcënime nga Peri Nacaj, bashkëshorti i Lulës, për kujdestarinë e fëmijëve. "Më ka dërguar SMS, më ka akuzuar që unë kam qenë bashkëfajtores me marrjen e fëmijëve, më ka kërcënuar edhe motra e tij. Unë kam parë vetëm atashimin prind-fëmijë. Ai më ka dërguar vazhdimisht SMS dhe fyerje pa fund, më ka kërcënuar me jetë", - sqaroi ajo. Sakaq, psikologja pohoi se: "Nuk ka ligj që ia jep kujdestarinë e fëmijëve një babai që rri në Amerikë, kur nëna është këtu".



## Andi Çeliku vazhdon detyrën deri në zëvendësimin e tij U përfundon mandati, katër anëtarë të Gjykatës së Lartë dorëzojnë detyrën

**TIRANË** - Katër anëtarë të Gjykatës së Lartë kanë dorëzuar detyrën për shkak të përfundimit të mandatit. Bëhet fjalë për gjykatësit Evelina Qirjako, Aleksandër Muskaj, Guxim Zelenaj e Arjana Fullani, të cilët kanë njoftuar me shprehje individuale kryetarin e gjykatës për largimin e tyre nga detyra. Në mbledhjen e trupës së gjyqtarëve është vendosur për përfundimin e mandatit për pesë anëtarë, pasi kanë plotësuar afatin prej nëntë

### ZËVENDËSIMI

Ndryshe nga kolegët e tij, gjykatësi Andi Çeliku do të vazhdojë të qëndrojë në detyrë deri në zëvendësimin e tij nga një anëtar i ri. Lidhur me këtë situatë të re të krijuar, kryegjykatësi Zaganjori ka njoftuar presidentin e vendit, Ilir Meta.

vitesh të qëndrimit në detyrë. Por, ndryshe nga kolegët e tij, gjykatësi Andi Çeliku do të vazhdojë të qëndrojë në detyrë, deri në zëvendësimin e tij nga një anëtar i ri. Lidhur me këtë situatë të re të krijuar, kryegjykatësi Zaganjori

ka njoftuar presidentin e vendit, Ilir Meta. Në fakt, kjo nuk është hera e parë që një anëtar i Gjykatës së Lartë dorëzon detyrën me mbarrimin e mandatit. Ardian Nuni vendosi të largohet nga detyra menjëherë sapo



mbledhja e gjyqtarëve vendosi të deklarojë përfundimin e mandatit të tij. Qëndrim të kundërt mbajti anëtarit tjetër, Ardian Dvorani, i cili prej më shumë se dy vitesh qëndron në detyrë, edhe pse mandati i ka përfunduar. Largimi i katër anëtarëve duket se vë në vështirësi funksionimin e

gjykatës, e cila përbëhet nga 19 anëtarë. Për momentin gjykata funksionon me një trupë prej 10 anëtarësh, për shkak se më herët dha dorëheqjen Mirela Fana, ndërsa Majlinda Andrea, e cila u dënua për korruption prej kohësh nuk e ushtron detyrën.

### SHKURT

**Lufta kundër drogës,  
Çako: Kemi 5 grupe  
kriminale nën hetim**

**TIRANË** - Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Haki Çako, gjatë fjalës së mbajtur dje në Zyrrën Operacionale të Situatës për raportim të Task Forcës ka deklaruar mes të tjerash se policia ka në hetim 5 grupe të strukturuar kriminale, që dyshohet se merren me prodhim, shitje dhe trafik lëndësh narkotike marijuanë. Ai tha se janë identifikuar pasuritë dhe astetet e tyre si shoqëri tregtare, hotele, lokale, bane, tokë truall, automjete etj. "Policia e Shtetit është e vendosur për ta finalizuar me sukses këtë betejë si dhe të çojë përpara gjykimin ata zyrtarë që nuk kryejnë detyrën si duhet", - ka thënë ndër të tjera në fjalën e tij, Çako.

**Konflikti për pronën,  
breshëri plumbash ndaj  
një automjeti në Kamëz**

**TIRANË** - Zbardhen detaje të reja në lidhje me ngjarjen e ndodhur mbrëmjen e së dielës në Kamëz, ku persona ende të paidentifikuar kanë qëlluar me breshëri plumbash në drejtim të një mjetei tip "Audi" të parkuar në lagjen "Kodër-Haxhë". Burime nga policia e kryeqytetit bënë me dije se mjetei ndaj të cilit u qëllua me armë zjarri është në pronësi të Mehmet Cokut. Policia ka nisur hetimet, ndërsa pista kryesore është ajo e konfliktit për çështje pronësie. Pronari i mjetei, Mehmet Coku është marrë në pyetje, ndërsa ka dëshmuar se nuk ka konflikte me njeri.

**Vetëvaret në burgun  
e Zaharisë 48-vjeçari  
i dënuar për vrasje**

**KRUJË** - Një i burgosur është gjetur i vetëvarur në ambientet e burgut të Zaharisë në Krujë. Bëhet fjalë për 48-vjeçarin me iniciale T.Z. nga Berati, i dënuar për vrasje. Sipas policisë, ai u gjet i vetëvarur me çarçaf, ndërsa ende nuk dihen shkaqet dhe motivet. "Më datë 30.07.2017, rreth orës 11:30, në ambientet e I.E.V.P. Zahari, Krujë është gjetur i vetëvarur shtetasi T.Z. (i dënuar për vrasje) 48 vjeç, banues në Berat. U kryen veprimet e para procedurale në bashkëpunim me Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve dhe dyshohet se ky shtetas është vetëvarur me çarçaf në ambientet e I.E.V.P. Materiali i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë për vlerësim", thuhet në njoftimin e policisë së Durrësit.

Policia e Vlorës: Atentatori e qëllloi me 6 plumba në trup babain e 3 fëmijëve

# Ekzekutimi i Renato Omerit, shoqërohen dhe merren në pyetje 10 persona

Dy vite më parë, "Reni" i shpëtoi atentatit në Durrës

### VLORE

Vrasja në atentat e 37-vjeçarit Renato Omeri, i cili njihet edhe me emrat Marjen Xhaferaj dhe Alias Marjen Omeri ka alarmuar policinë e Vlorës, e cila së bashku me prokurorinë janë duke hetuar intensivisht për identifikimin dhe vënien në pranga të autorëve të krimit. Pas ngjarjes së rëndë të ndodhur mbrëmjen e së premtes në një lokal në zonën e Lungomares, blutë kanë shoqëruar dhe marrë në pyetje mbi 10 persona, disa prej të cilëve me precedent penal. Por, pavarësisht hetimeve të kryera, ende nuk është bërë e mundur rënia në gjurmët e atentatorit. Ndërkohë, mësohet se atentati ku mbeti i vrarë Renato Omeri, të cilët miqtë e thërrisnin "Reni" ishte i treti që organizohet ndaj tij. Burime pranë grupit hetimor dje bënë me dije se dy muaj më parë ai shpëtoi në një tentativë për ta eliminuar, në një kazino në Vlorë, ngjarje kjo që nuk u bë publike në atë kohë. Por, ngjarja më e bujshme, së cilës i mbijetoi Omeri është ajo e ndodhur më 20 dhjetor të vitit 2015 në afërsi të Torrës, përballë portit të Durrësit. Në këtë ngjarje mbetën të vrarë shtetasit: Ervin Kodra dhe Endri Çauhaj, nip i Renato Omerit. Burime konfidenciale nga policia pohuan se shënjestër e këtij atentati me dy viktima ka qenë pikërisht 37-vjeçari, baba i tre fëmijëve. Sipas këtyre burimeve, 28-vjeçari Kodra, 25-vjeçari Çauhaj (student i shkëlqyer) dhe Renato Omeri kanë qenë në një lokal duke pirë kafë. Në një moment, Çauhaj u ka thënë dy të tjerëve se do të dilte të blinte cigare. Ervin Kodra ka thënë se do të dilte dhe ai që të blinte diçka, por sapo kanë hipur në makinën tip fuoristradë (në pronësi të Kodrës) janë qëlluar për vdekje me breshëri automatiku. Në atë kohë fati ka ndihmuar



Viktima, Renato Omeri



Vendi ku ndodhi atentati

### VIZITA

Sipas burimeve policore, Renato Omeri kishte shkuar për vizitë tek motra e tij dhe kishte dalë për të pirë një kafë poshtë pallatit kur u bë atentat. Vetëm dy muaj më parë, 37-vjeçari i kishte shpëtuar një atentatit tjetër në një kazino në Vlorë. Mësohet se atentati i dy muajve më parë është bërë vetëm pak metra më larg se atentati që u bë mbrëmjen e së dielës.

Renato Omerin, i cili pas kësaj ngjarjeje ruhej. Ai i kishte lëvizjet e kufizuara pranë shtëpisë apo lokalit të tij dhe gjatë gjithë kohës ishte i armatosur. Edhe mbrëmjen e së dielës, 37-vjeçari mbante një pistoletë në brez. Ai nuk ka mundur të nxjerrë armën në momentin kur u qëllua nga një person ende i paidentifikuar.

### HETIMET

Pas kryerjes së veprimeve hetimore paraprake, hetuesit e çështjes pohuan se Renato Omeri u qëllua me 6 plumba nga atentatori, i cili u largua me shpejtësi në mes pallateve të zonës, në drejtim të "Ujit të Ftohtë". Sipas bluve, babai i tre fëmijëve u qëllua nga një i ri i veshur sportiv dhe me

kapele në kokë. Ndërkaq, policia dhe prokuroria e Vlorës janë duke hetuar në disa pista për zbardhjen e motivit të krimit. Paraprakisht dyshohet se atentati i mbrëmjes të së dielës në Vlorë ka lidhje me të kaluarën e viktimit, përfshirë këtu edhe ngjarjen e dy viteve më parë në Durrës. Ai rezultoi një person me pre-

cedentë kriminalë në Europë dhe kryesisht në Itali në fushën e narkotrafikut. Renato Omeri përdorte disa emra, por vetëm dy kishte të regjistruar në gjendjen civile. Renato Omeri ishte emri i tij i vërtetë, ndërsa njëherë dhe si Marjen Omeri dhe Marjan Xhaferaj, duke mbajtur në këtë rast mbiemrin e bashkëshortes.

## SHKRIMTARËT KOMUNIZMI


EKSKLUZIVE/ Publikohet kontrata e ministres Tefta Cami me francezët për "Gjeneralin..." dhe korrespondenca e Ministrisë së Jashtme me ambasadën në Paris

# Drejtori i Kinostudios: Zoti Piccoli, ne s'ju plotësojmë dot kërkesat tuaja për "Gjeneralin"

Vangjush Zallëmi: Duhet të bëhen disa formalitete të domosdoshme, plotësimi i të cilave kërkon një kohë të gjatë. Për këto arsye, propozojmë që xhirimi i filmit të shtyhet për më vonë

DASHNOR KALOÇI

Në mesin e vitit 1982, kur shoqëria filmike franceze "FLMSS 66", e përfaqësuar nga aktori i njohur Michel Piccoli, ishte bërë gati për të ardhur në Shqipëri dhe për të filluar xhirimet e filmit "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", sipas skenarit të përshtatur nga romani me të njëjtin titull të shkrimtarit të njohur Ismail Kadare, papritur u ndeshën me një sërë problemesh të ngritura nga pala shqiptare, e cila iu propozonte për një shtyrje të fillimit të xhirimeve. Gjë e cila për ta, as më shumë dhe as më pak do të thoshte se realizimi i filmit nga ana e tyre ishte në kufijtë së pamundurës. Por cila ishte arsyeja kryesore që pala shqiptare u nxirrte pretendime pas pretendimesh francezëve dhe, a kishte mundësi reale shteti shqiptar për t'i qëndruar korrekt kontratës që kishte lidhur me shoqërinë filmike "FILMSS 66"? Nga shumë burime të besueshme bëhet e ditur se pretendimet e palës shqiptare për realizimin e filmit s'ishin gjë tjetër veçse pretekste subjektive të ngritura artificialisht për t'ua nxirë jetën francezëve, aq sa i detyroi ata që të tërhiqeshin nga projekti i tyre për realizimin e filmit dhe më pas ta zhvendosnin atë në jug të Italisë, siç dhe ndodhi më pas. Problemi kryesor ishte "çështja Kadare", autori i skenarit të filmit, ndaj të cilit pikërisht në ato ditë, në një nga qelitë e hetuesisë të Burgut 313 në Tiranë (ku zhvillohej procesi hetimor i të ashtuquajturit "Grupi armiqësor i Mehmet Shehut dhe Kadri Hazbiut"), "po rrefeje" ish-ministri i Shëndetësisë, Llambi Ziqishti, duke akuzuar edhe Kadarenë si pjesëtar i atij grupi. Por edhe pse "dosja Kadare" u mbyll, filmi "Gjenerali..." nuk u realizua dot, dhe arsyet e vërteta nuk u thanë kurrë e nuk janë bërë ende publike edhe sot, pas 27 vjetësh nga shembja e regjimit komunist. Ndërsa, lidhur me pengesat dhe pretendimet e palës shqiptare (me një pjesë të të cilave u njohëm në kapitullin e kaluar), bëhet fjalë në këto dokumente arkivore të deklasifikuara tashmë, që po i publikojmë të plota në këtë pjesë të librit.



Romani "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" i Kadaresë në gjuhë të huaj

**INFORMACION MBI PROBLEMET PËR XHIRIMIN E FILMIT "GJENERALI I USHTRISË SË VDEKUR"**

Më 28 korrik erdhi në vendin tonë Misha Pikoli dhe Hyg Nonn, drejtor i filmit, për të përfunduar përgatitjet për fillimin e xhirimeve të filmit "Gjenerali i ushtrisë së vdekur". Pikoli u largua më datë 4 gusht dhe po këtë ditë erdhi Luçiano Tovoli (regjisori i filmit), i cili mbasi pa edhe një herë vendet e xhirimit, u largua më 18 gusht. Ndërsa Hyg Nonn do të largohet më 25 gusht së bashku me Zhan-Lyk Milori, asistent regjisor i parë dhe Domink Tabyto, asistent regjisor i dytë, të cilët erdhën më 4 gusht.

Sipas porosisë të dhëna nga K.Q. i PPSH, shoku Vangjush Zallëmi mori takim me Luçiano Tivolini dhe personat e tjerë të palës franceze, të cilëve u ka shtruar këto probleme:

1. Filmi "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" nuk është një bashkëpunim me Kinostudion "Shqipëria e Re". Ajo i jep vetëm ndihmë teknike, prandaj filmi është prodhim ekskluziv i "Filmss 66". Si rrjedhim, në titujt e filmit të lartpërmendur nuk do të pasqyrohet personeli shqiptar dhe shërbimi i Kinostudios "Shqipëria e Re".
2. Mbasi të rishikohen vendet e xhirimit, para largimit pala franceze duhet të saktësojë afatet e xhirimit dhe kërkesat që kanë. U

theksua se shtyrja e herëpashershme e afateve i ka sjellë pengesa dhe dëme Kinostudios, prandaj është e domosdoshme që afatet që do të caktohen të respektohen sipas marrëveshjes që do të nënshkruhet nga të dyja palët. Shkelja e afateve të përcaktuara në marrëveshje do të sjellë prishjen e saj dhe Kinostudioja nuk do të mbajë asnjë përgjegjësi për xhirimin e filmit.

3. Pala franceze duhet të dërgojë listat për personelin që do të marrë pjesë në xhirimin e filmit me të gjitha gjeneralitetet përkatëse. Këto të dhëna t'ua dërgojë edhe ambasadave tona në Paris dhe Romë, si dhe Kinostudios.

4. Iu sugjerua që xhirimi i filmit të fillojë më 14 tetor dhe të përfundojë 25 dhjetor 1982.

5. Mbasi të përcaktohen të gjitha shpenzimet që duhet të bëjë Kinostudioja, sipas preventivave dhe listave përkatëse, pala franceze duhet të derdhë në bankën e shtetit shqiptar të gjithë shumën e nevojshme një muaj para fillimit të xhirimit të filmit.

6. "Filmss 66", me të mbaruar filmi, duhet t'i japë Kinostudios një kopje dubël-negative falas për përdorim brenda vendit.

7. Gjithashtu u sugjerua që të grupohen vendet e xhirimit dhe të evitohet ndonjë objekt i përcaktuar më parë për t'u xhiruar.

Lidhur me këto probleme, grupi francez ka dhënë këto përgjigje:

1. Ramë dakord që të nënshkruhet një marrëveshje dhe t'i përmbahen asaj. Theksuam se më datë 25 gusht do të përcaktojmë të gjitha gjërat dhe marrëveshja e firmosur do t'i paraqitet Kinostudios brenda gushtit.

2. Ramë dakord të dërgojmë listat me të gjitha formalitetet e nevojshme. Më datë 6 gusht M. Pikoli ka dërguar listat emërore të teknikëve e të artistëve francezë, të teknikëve italianë, por në të nuk përfshihen akoma emrat e listave të artistëve italianë. Ka premtuar se edhe pjesën tjetër do ta dërgojë së shpejti.

3. U përgjigjen se xhirimet e filmit do të fillojnë më datë 14 tetor dhe do të përfundojnë më datë 25 dhjetor. Gjithashtu u shprehën se iu vjen keq që nuk e bënë xhirimin e filmit në afatet e caktuara më parë për shkak të arsyeve financiare.

Së shpejti, libri më i ri "Shkrimtarët dhe artistët nën diktatin komunist...", i gazetarit dhe studiuesit të njohur Dashnor Kaloçi

4. Kanë dërguar një pjesë të fondeve dhe kanë shtuar se pjesën tjetër, sipas marrëveshjes, do ta dërgojnë së shpejti.

Nga korrespondencat dhe bisedat e zhvilluara këto ditë, grupi franco-italian ka paraqitur në Kinostudio kërkesat e mëposhtme:

1. Të vërë në dispozicion për xhirimin e filmit një personel teknik dhe artistik prej 30 vetash, kundrejt pagesës.

2. Të përgatisë objektet e xhirimit dhe dekoret në natyrë.

3. Të vërë në dispozicion të grupit francez mjetet teknike për lëvizjet e grupit, dhe konkretisht 5 vetura, 9 autobusë, 15 kamionë, si dhe mjete të tjera që do të përdoren për rekuizitën.



Tefta Cami



4. Të sigurojmë një numër kostumesh dhe rekuizitë për xhirimin e filmit.

5. Të sigurojmë rreth 1.000 figurantë, sipas episodeve që do të xhirohen në film, ndër të cilat nusën, dhëndrin, një portier dhe një pastrues në hotel "Dajti", role këto të fundit të vegjël pa fjalë.

6. Filmi që do të xhirohet pjesë-pjesë duhet të nisët çdo të mërkurë në Paris, por dogana e Rinasit nuk duhet t'i hapë kutitë e filmit, mbasi filmi është i pazhvilluar dhe del jashtë përdorimit. Kutitë me film duhet të shoqërohen në aeroport nga një përfaqësues i grupit francez dhe një shqiptar, dhe këto laboratorit i Parisit do t'i kthejë në video-kasetë për t'u parë në Shqipëri nga grupi.

7. Në episodin e natës, kur prifti me gjeneralin dalin në ballkonin e hotel "Dajti", karshi hotelit duhet të lëvizin disa tanke e mjete transporti dhe rreth 150 ushtarë, për të dhënë përshpirtjen e përgatitjes së paradës.

9. Shpenzimet e fjetjes dhe të ushqimit grupi do t'i bëjë pranë hoteleve me para në dorë. Ndërsa shpenzimet e tjera do të bëhen nga Kinostudioja, të cilat faturohen çdo javë të firmosura nga përfaqësuesi i grupit francez dhe ai i Kinostudios, dhe pastaj banka do t'ia kalojë Kinostudios.

10. Shpenzimet e karburantit për automjetet që do të jenë në dispozicion të grupit, si dhe ato të rekuizitës, do të bëhen direkt nga pala franceze. Kanë shfaqur dëshirën që në vendet e xhirimit të krijohen kushte të përshtatshme shërbimi.

11. Kanë çelur kredi në bankën tonë, nga e cila kanë mbetur pa u konsumuar 87.000 franga, të cilat do të shërbejnë për shpenzimet e përgatitjes së objekteve të xhirimit.

12. Kanë shprehur dëshirën se nuk janë të mendimit të lejohen të vijnë në Shqipëri, për qëllime reklamë të filmit, gazetarë apo fotografë të huaj.


13. Kanë kërkuar që gjatë kohës së xhirimit disa nga pjesëtarët e grupit kanë dëshirë të sjellin në Shqipëri për një kohë, me shpenzimet e tyre, gratë, burrat dhe fëmijët e tyre.

14. Nga Italia, përveç materialeve të ndryshme, si





Ministria Tefta Cami duke pritur një delegacion të huaj



aparatura xhirimi etj., do të sjellin nëpërmjet Tivarit me vapor katër makina speciale xhirimi. Kanë theksuar se gjatë lëvizjeve nëpër Shqipëri këto të jenë në autokolonë, së bashku me makinat e tjera të grupit të shoqëruara nga makina shqiptare, si dhe nga një person i grupit shqiptar. Njëkohësisht kërkojnë që një makinë e "Transshqipit" me sipërfaqe të lirë prej 20 m3 dhe me një peshë 1 ton e gjysmë të jetë në Paris më 20 shtator për t'u ngarkuar, që më 24 shtator të niset për në Tiranë.

Ministritë së Mbrojtjes të inkludohet me grupin e punonjësve tanë të Kinostudios që do të punojë me grupin franko-italian të xhirimit, i cili të kontrollojë dhe të ndjekë nga afër xhirimet. Për këtë gjë do t'i propozojmë Ministrisë së Mbrojtjes. Gjërat kryesore që lidhen me xhirimet e film-it, disa nga të cilat ngrihen edhe në këtë informacion, do të përcaktohen në marrëveshjen që do të nënshkruhet midis Kinostudios dhe "Filmss 66".

Tiranë, më 23.8.1982

Ministri (Tefta Cami)


Sh. Reiz  
Po ju dërgoj projektin e përgjigjeve që mund t'u jepen francezëve.

Ju lutem i shikoni shpejt sepse duhet t'i komunikojmë me shokun Manush.

Dt. 24.8.1982 Të fala

Shënim: Vërejtjet tona ia dhashë shoqes Tefta në telefon sipas shënimeve në dorëshkrim. Ramë dakord që për këto të marrë miratimin nga shoku Manush.  
Reiz Malile. 24.8.1982

DISA ARSYE QË MUND T'I NGRIHEN PALES FRANCEZE PËR SHTYRJEN E AFATIT TË



Aktori francez, Michel Piccoli

XHIRIMIT TE FILMIT "GJENERALI I USHTRISE SE VDEKUR"

Sipas porosive që u dhanë në takimin e organizuar nga shoqja Tefta Cami më datë 24 gusht 1982 me shokun Reiz Malilë, Mehmet Çaka, Veli Llakaj, Anastas Kondo etj., ku u diskutua lidhur me nënshkrimin e marrëveshjes midis Kinostudios "Shqipëria e Re" dhe "Filmss 66", u mendua që t'i propozohet palës franceze që të shtyhet afati i fillimit të xhirimit të filmit, duke ngritur këto arsye:

1. Varianti përfundimtar i skenarit të filmit i është dhënë autorit të romanit, Ismail Kadare, vetëm kohët e fundit. Ai mbasi e studioi shpejt e shpejt i ka dhënë disa mendime dhe vërejtje paraprake Luçiano Tovollit, duke i thënë se mbasi në studim më të thelluar do të bënte sugjerime të tjera. Në takimin që patëm ne si Kinostudio me Ismail Kadarenë, ai paraqiti se ka një sërë rezervash për skenarin. Duke u nisur nga ky mendim, ne si Kinostudio, që kemi marrë përsipër që të japim ndihmë teknike për realizimin e filmit, nuk mund të marrim asnjë veprim të mëtejshëm, pa marrë përfundimisht pëlqimin e autorit.

2. Meqenëse gjatë muajit tetor-nëntor në vendim tonë ka disa aktivitetet të rëndësishme dhe kemi festat kombëtare, mbasi iu drejtuar organeve të Tregëtisë, ato na u përgjigjën se gjatë kësaj kohe e kanë të pamundur plotësimin e kërkesave tonë për xhirimin dhe fjetjen gjatë kësaj periudhe.

3. Sipas rregullave doganore të vendit tonë, nuk mund të nxirren jashtë vendit materiale pa u kontrolluar më parë nga ana e saj. Ju kini kërkuar që kutitë e filmit të mos hapen në doganë, mbasi filmi është i pazhvilluar dhe mund të prishet. E biseduam këtë problem me doganën, e cila na u përgjigj që për të lejuar këtë duhet të bëhen disa formalitete të domosdoshme, plotësimi i të cilave kërkon një kohë të gjatë.

Për këto arsye, propozojmë që xhirimi i filmit të shtyhet për më shumë.


Vangjush Zallëmi  
Gjergji Pano  
Niko Mitrushi  
24.8.1982

T E L E G R A M

Zotit Mishel Pikoli PARIS

Përgjigje e telegramit tuaj datë 21.9.1982.

Për sa i përket ndihmës sonë teknike për xhirimin e filmit tuaj, ne nuk kemi ndërruar asnjëherë mendim dhe asnjëherë nuk e kemi



braktisur atë. Me telegramin tonë të 11 shtatorit ju njoftuam se nuk mund t'jua plotësonim dot të gjitha kërkesat tuaja. Në qoftë se ju keni gjetur zgjidhje tjetër, kjo është puna juaj dhe ne nuk mbajmë përgjegjësi për këtë. Ne nuk njohim shpenzimet dhe investime e padobishme të bëra nga ana juaj, përdërisa nuk e kemi braktisur filmin tuaj. Në qoftë se bëhet fjalë për këtë, jemi të detyruar t'ju bëjmë të ditur se shpenzime dhe investime të padobishme, siç e dini, janë bërë nga ana jonë në dhjetor 1981 dhe në janar e shkurt 1982, kur ju nuk erdhët për të bërë xhirime, siç kishim vendosur dhe, me gjithë këtë, nuk iu kërkuat të riparim dëmin tonë.

Me respekt i juaj i sinqerisht Vangjush Zallëmi Drejtor i Kinostudios  
SH I F R I M TEPER SEKRET NR.2906.2907  
Adresa: Ambasada Paris  
Koncepti: Në letërën e datës 30 gusht, që Michel Piccoli i ka dërguar drejtorit të Kinostudios, ankoheret se po pengojmë xhirimin e filmit. Në përgjigje të kësaj letre, shoku Vangjush Zallëmi i thotë se ne nuk kemi refuzuar, por ju kemi thënë se ne nuk kemi mundësi të plotësojmë të gjitha kërkesat që keni paraqitur.



## KASTRIOT DERVISHI PUBLIKON DOKUMENTIN E PANJOHUR

# Dosjet e motrës së Kadaresë dhe Asamble Hatibit, gruas që e quante Enver Hoxhën "pederast, pis, vrasës"

Letra e datës 2.4.1980 e shkrimtarit Ismail Kadare drejtuar Enver Hoxhës, është pjesë e një historie "me grupe armiqësore" të nisur në vitin 1978, në të cilën implikohet edhe motra e tij, Kadria. Njohja e letrës pa ditur shkakun e saj është një histori e copëzuar dhe e pashpjeguar mirë. Shkrimi i kësaj letre është një përpjekje njerëzore për të shpëtuar motrën e vet nga burgosja thuasje e sigurt. Ajo letër është gati e njëlojtë për nga përmbajtja dhe qëllimi me qindra letra të tjera të të dënuarve që kërkojnë faljen e dënimit me vdekje.

Kadria ose Kakuka siç e njohim ne, ka qenë një antikomuniste e njohur në vitet '70-'80, e singërtë me shumë nga ç'duhej në atë lloj shoqërie të gatshme për të spiunuar. Në shumë raste, agjitate kundër regjimit, duke pasur për bazë edhe bisedat që bënte në shtëpi. Duke mos menduar asnjëherë për rrezikun që i vinte nga ziliqarët, spiunët e dashakeqët, ajo i deklaronte me një sinjeritet të habitshëm mendimet e veta. Kadria është këshilluar nga zëvendës-drejtori i Punëve të Brendshme të Tiranës, Nusret Dautaj, ndërsa vëllai i saj është thirrur në Komitetin e PPSH-së së Tiranës. Këtu e kanë këshilluar që, meqë është prekur emri i Enver Hoxhës, duhej patjetër t'i bënte një letër atij.


Në vitin 1978, Drejtorja e Punëve të Brendshme Tiranë, mbi bazë të një denoncimi çeli dy probleme të centralizuara: "Shtirigat" dhe "Krokodili". Në thelb të këtyre çështjeve ishte emri i Enver Hoxhës, i zënë me gojë në mënyrë të ashpër edhe për pederastinë e tij nga disa prej personave të implikuar. Çështja përfundoi me disa burgosje, këshillime dhe me një vetëvrasje.

Asamble Hatibi kishte pakënaqësi ndaj regjimit sepse komunistët i vranë në mënyrë kriminale bashkëshortin në vitin 1947. Ajo u arrestua shumë shpejt me urdhër të Feçor Shehut sapo përforcioi fjalët për figurën e keqe morale të Enver Hoxhës. Kësisoj, organet e punëve të brendshme ishin vigjilente për të mbrojtur kreun e regjimit të Tiranës.

Vendimi për hapjen e dosjes agjenturiale "Shtirigat" u mor më 27.9.1978. Në të u implikuan:

1- Asamble Hatibi, lindur më 1924 në Tiranë, punëtore në ndërmarrjen artistike "Migjeni", u vu në përpunim aktiv 2A më 18.7.1978. U arrestua më 10.10.1978. U dënua me 7 vjet burgim, në bazë të nenit 55 të Kodit Penal, për agjitacion e propagandë. Ajo kishte thënë:

"Koçi Xoxe me Enver Hoxhën kanë qenë njëloj, kanë punuar bashkë, por Enveri kur pa se Koçi e donin më shumë dhe ishte rrezik se do



Enver Hoxha

ta ulnin atë dhe do të vinin Koçin, atëherë ktheu politikën dhe bëri grusht, nuk sulmoi jugosllavët, por ia vuri të gjitha Koçit, demok se ishte katil... Çdo 10 vjet Enveri bën fushata vrasjesh, siç qe rasti i Beqir Ballukut, Kiço Ngjelës etj. Ky ka qenë shkaktar i (vrasjes) së vëllezërve Kokalari gjatë luftës, burri tim Galip Hatibi e shumë të tjerëve. Ai vret ata që dinë për të, është pederast, pis, Zeus, vrasës, diktator si Franko etj."

2- Kadrie Kadare, lindur më 1937 në Gjirokastrë, pedagogë në ILB Kamëz. U vu në përpunim paraprak më 15.7.1978. Më parë ishte marrë në përpunim aktiv 2A më 3.11.1976, fillimisht si "si agjente e mundshme" në shërbim të zbulimeve të huaja, e më pas u ndryshua tendenca në agjitacion e propagandë më 4.2.1977. U këshillua më 3.8.1978. Megjithatë, vazhdomte të bënte agjitacion e propagandë sepse "tjet shumë ashpër kundër udhëheqësve të partisë e të shtetit". Fjalët e saj ishin ndër të tjera: "Shteti harxhohet për të përkthyer veprat e Enver Hoxhës për t'i botuar jashtë, por bota nuk pyet për to. Vëllai im ia ka hedhur Enver Hoxhës dhe ai është i zoti. Po ndër-

roi situata, do mbretërojë me librat e tij".

3- Egërem Biba, lindur në Tiranë më 1917, redaktor në shtëpinë botuese "Naim Frashëri". Ka një histori të vitit 1964. U vu në përpunim 2A më 14.9.1978. I përmenden bisedat që ka zhvilluar për jetën luksoze të udhëheqësve. U arrestua më 20.2.1980. U dënua me 9 vjet heqje lirie në bazë të nenit 55 të Kodit Penal.



Ismail Kadare

4- Lela Petrela, lindur në

Tiranë më 1923, muzikant, mësues fizike. U vu në përpunim 2A më 23.9.1978. Ishte këshilluar në vitin 1951. Zhvillonte biseda armiqësore. Citohej se në shtëpinë e tij shiheshin filma të huaj, se ai diskutonte keq për Leninin etj.

5- Durim Hatibi, lindur në Tiranë më 1947, biri i Asamblesë, punëtor në Ndërmarrjen Gjeologjike. Në kallëzim për të thuhet: "Është tepër korrekt, tepër i mbyllur, por

në gjoksin e tij zien një vullkan". U këshillua.

6- Marilda Veshi, lindur më 1935 në Shkodër, redaktore në Shtëpinë e Librit Shkollor. U vu në përpunim paraprak më 15.9.1978. Shënohet se bënte biseda

1927, nëpunëse në pension. U arrestua më 21.9.1979. Cilësohej "element antiparti", lidhje e Todi Lubonjës. Shoqe e Asamble Hatibit. U dënua me 5 vjet burgim, në bazë të nenit 55 të Kodit Penal.

9- Drita Çausi, pedagogë në ILB Kamëz. Shoqe me Asamblenë, me të cilën ka zhvilluar biseda armiqësore. U këshillua.

Denoncimet nisën pas kallëzimit më 12.8.1978 ndaj Asamblesë dhe shoqeve të saj. Kohë pas kohe, u informua për zhvillimet sekretari i parë i Komitetit të PPSH-së të Tiranës, Simon Stefani.

Në problemin e centralizuar "Krokodili" u implikuan:


1- Egërem Biba (nxjerrë nga "grupi" i mëspërm).

2- Hysenil Dume, lindur në Selanik më 1925, nëpunës në shtëpinë botuese "Naim Frashëri", i përgjatur nga partia, arrestuar më 5.7.1980. U dënua me 9 vjet burgim, sipas nenit 55 të Kodit Penal.

3- Xhelal Ramku, lindur në Tiranë më 1932, i përjashtuar nga partia, nëpunës, arrestuar më 21.3.1980. U dënua së bashku me Egërem Bibën, me 9 vjet burgim, sipas nenit 55 të Kodit Penal.

## NESËR:

- Deklarime të Asamble Hatibit mbi moralin e diktatorit.
- Deklarimet e rrezikshme të Kadrie Kadaresë kundër Enver Hoxhës dhe regjimit komunist.





# SUMMER

pages

SUPLEMENT I GAZETA SHQIPTARE

E martë 1 Gusht 2017



KENGETARJA

**ZAIMINA PËRGËNJESHTRON  
SHTATZËNINË  
KËNGËTARJA POSTON FOTON SEKSI**



**Heq rrobat e juristes  
Ja si duket Eni Çobani në plazh**

**BULEVARDI  
POLITIK**



- Kë po "kërcënon" me gërshtë në dorë deputetja e PS-së?!
- Erion Veliaj bëhet nostalgjik, si i kaloi dy vjet në krye të bashkisë
- Historia e teshtimës në fjalimin e Enver Hoxhës
- Historia që u tregoi Rama deputetëve: Si arriti Nastradini tek e vërteta



# SHEZAI RROKAJ:

## Nuk jam xheloz nëse vlonjatët duan më shumë Edi Ramën

*"Ju rrëfej kalimin nga jeta  
akademike në politike"*

Rrëfhet deputeti i LSI: Ja plani im për politikën. Do bëj opozitë konstruktive

# Shezai Rrokaj:

## Nuk jam xheloz nëse vlonjatët duan më shumë Edi Ramën “Ju rrëfej kalimin nga jeta akademike në politikë”

Pamela Aliaj

Shezai Rrokaj është i vetmi përfaqësues i LSI-së, i cili ariti të fitonte mandatin e deputetit në Vlorë. Rrokaj ka qenë para pak kohësh në rolin e akademikut dhe dekanit në UT në Tiranë, ndërkohë që në këto zgjedhje ai ndërmori një tjetër rrugë, atë politike. Në një intervistë për “Summer Pages” të “Gazeta Shqiptare”, Rrokaj ka folur lidhur me sfidat që e presin në këtë detyrë të re; përse zgjodhi rrugën politike, duke qenë akademik. Gjithashtu, deputeti i LSI-së për Vlorën ka folur edhe për marrëdhënien e tij me kryeministrin dhe pozicionimin që do të ketë në parlament sapo të nisë detyrën në shtator.

**Si ndiheni tani që fituat mandatin e deputetit të LSI për Vlorën?**

Ndihem krenar, sepse jam deputet në qytetin tim të lindjes, me të cilin më lidhin një mijë fije si: dashuria për vendlindjen, fëmijëria, malli, të afërmit, njohjet e shumta, por edhe që vij nga një qytet ku antikiteti e lidh me Orikun e lashtë dhe Amantian. Mesjeta me Kalanë e Kaninës dhe Donika Kastriotin, me pavarësinë dhe lindjen e shtetit, Luftën Nacionallçirimitare me të cilën Vlorë e Labëria ka një lidhje të pandashme etj. Ndihem gjithashtu mirënjohës ndaj të gjithë votuesve të LSI-së, që në kushte të pazakonta të trysnisë shtetërore dhe të blerjes së votës, e dhanë votën e tyre, me qëllim që edhe qarku Vlorë të përfaqësohet në Kuvendin e Shqipërisë. Sigurisht që ndiej përgjegjësi për t'i përfaqësuar ata dhe të gjithë qytetarët e këtij qarku me dinjitetin që meritojnë.

**Cili do të jetë pozicionimi juaj në Parlament? Roli kyç që do të kenë?**

Kjo gjë do të varet nga detyrat që do të më ngarkohen prej grupit parlamentar, si dhe prej ndarjes së përgjegjësisë në komisione. Por, përtej kësaj, roli im do të jetë një rol prej opozitari, që shkon edhe me vetë natyrën jokonformiste që kanë intelektualët. Përveç problematikave që do të dalin gjatë jetës parlamentare, besoj se në fushën e arsimit dhe shkencës, në fushën e kulturës dhe të qeverisjes vendore, roli im ka për të qenë më i spikatur.

**Si do të jenë marrëdhëniet me Edi Ramën tani që jeni deputet i Vlorës?**

Do t'ia kujtoj shpesh se është deputet i saj, në mënyrë që qarku Vlorë të marrë vëmendjen që meriton. Në planin e komunikimit etik



do të jenë korrekte dhe të ndërsjella. Në planin politik do të ketë një opozitarizëm konstruktiv. Por, natyrisht qëndrimet e mia do të jenë të lidhura me nevojat konkrete që kanë qytetarët e këtij qarku.

**Kryeministri ka thënë se deputetët e qarqeve duhet të nxjerrin emrat e punonjësve të administratave që nuk kanë dhënë rezultat pozitiv gjatë bashkëqeverisjes. C'mendim keni lidhur me këtë?**

Nëse është kështu si thoni ju, më duhet të pohoj se ky veprim është një nonsens institucional, pasi ngatërron pushtetet, ku deputetët marrin role të ekzekutiv-it, gjë që nuk është normale për pushtetin legjislativ. Pra, është një deformim kushtetues. Lidhur me faktin se pas kësaj fshihet guetia e shtrigave për të krijuar një alibi për goditjen e LSI-së, kjo nuk përbën më risi. Goditja politike për shkak të bindjeve politike është shfaqur qysh gjatë fushatës elektorale dhe kjo dëshmon se gjithçka flitet si propagandë për një administratë shteti demokratik, është vetëm një truk populist për të goditur LSI-në. Ne po e ndjekim këtë problematikë. Ne nuk i kemi dalë dhe nuk do t'i dalim mbështetjeju kudo që shkel ligjet e shtetit, por Edi Rama dhe kushdo qoftë nuk e kanë pronë private shtetin, ndaj do t'u dalim zot mbështetësve tanë dhe cilitdo që ndëshkohet për shkak të bindjes politike.

**Edi Rama është një ndër de-**

**putetët në Vlorë, kurse ju jeni i vetmi i LSI-së. Sipas jush, kë vlerësojnë më shumë vlonjatët, kryeministrin apo ju?**

Se kë duan më shumë vlonjatët, mua apo Edi Ramën, kjo nuk më xhelozon edhe po të duan atë më shumë, ndonëse vetëm këto vite ai po përmendet si vlonjat. Unë uroj që 8 deputetët e PS-së dhe unë, por edhe 3 deputetët e PD-së, kur është puna për investime në qarkun tonë, të mos kemi ngjyra partiake. Mjafton që ata të zgjidhin çështje jetike si: rrugët, uji, dritat gjatë gjithë vitit, shëndetësia, arsimit, punësimi, zhvillimi i turizmit në 170 km bregdet, ambienti etj.

**Cila është arsyeja e zgjedhjes së politikës?**

Në vitin 2008 unë u bëra pjesë e Komitetit për Mbrojtjen e Kush-tetutës, ku siç dihet PS-ja dhe PD-ja brenda një nate ndryshuan Kushtetutën, mu si në 17 maj të këtij viti. Asokohe, LSI-ja e bëri pjesë të aksionit të saj kundërshtimin e kësaj ndërhyrjeje, të cilën vite më vonë edhe këto forca politike e kanë njohur si gabim. Së dyti, gjatë mandatit tim si rektor i UT-së, në betejën time për autonominë universitare, kuptova se kjo betejë mund të fitohej edhe me, e sidomos, aksion legjislativ. Së treti, iu bashkëngjitja LSI-së, sepse kjo forcë promovon rininë si një pasuri kombëtare, me të cilën lidhej edhe jeta ime akademike. Pavarësisht ku je, e rëndësishme është të përqipesh në t'i bërë më mirë gjërat, duke iu përmbajtur disa parimeve themelore në jetën e një njeriu.

**Ju kenë qenë dekan i Fakultetit Histori-Filologji, si ishte kalimi nga profesor në deputet?**

Prej vitit 2008, kur u përfshiva në LSI, detyra ime themelore ka qenë ajo e akademikut. Në politikë kam pasur funksione si: kryetar i Tiranës, anëtar i kryesisë, anëtar i KDK-së dhe tani jam kryetar i KDK-së. Gjithashtu, kam qenë këshilltar në Bashkinë e Tiranës dhe në qarkun e Tiranës. Kanë qenë marrëdhënie përplotësuese. Por, për një gjë jam i sigurt: asnjëherë nuk kam shfrytëzuar njërën, për të realizuar tjetrën. Bie fjala, nuk jam zgjedhur dekan duke shfrytëzuar politikën, apo qenien time dekan ta vija në shërbim të politikës. Tani më duhet t'i kushtohem prioritarisht politikës, pa harruar rolin e akademikut, sepse mendoj se kështu mund të jem edhe më i dobishëm në



politikë.

**A ka ndikuar orientimi juaj politik në detyrën tuaj si profesor?**

Nuk besoj, në të kundërtën mundet. Qenia profesor më ka rritur përgjegjësinë ndaj arsimit, shkencës dhe të bërit politikë. Arsimit është një e mirë kombëtare, një pasuri që lidhet me vetë misionin e tij: hapja ndaj dijes, botës, universitetit nga njëra anë dhe përmirësimi të cilësisë së jetës nëpërmjet zotësisë profesionale nga ana tjetër. Politika është gasje për mirëbërjen e keqbërjen e kësaj pasurie, por çdo parti si entitet është shumë më pak se vlera kombëtare e universale e arsimit të një vendi.

**Ju jeni zgjedhur deputet i LSI-së në Vlorë. Cfarë roli do të luani për Vlorën si deputet. Cili është programi juaj?**

Kam thënë gjatë fushatës se do të jem një zë i fuqishëm në mbrojtje të interesave të qytetarëve. Do të bashkëpunoj me deputetët e spektit tjetër politik për të mbrojtur dhe promovuar interesat e këtij qarku, sikundër do të jem i vendosur që siç e theksova më lart, të kërkoj të mosshpërdorohet prej politikës me heroizmin vlonjat, që t'i kthehet Vlorës dinjiteti i qytetit prej nga lin-

di themelimi i shtetit. Qeveria duhet të heqë dorë nga megalomania për një Vlorë ‘perle e Mesdheut’ dhe më parë t’u kthehet punëve jetike për qytetarët: rrugëve, ujit, dritave, harmonizimit të pjesëve përbërëse të njësive administrative, llojeve të turizmit, arsimit dhe shëndetësisë, rrugëve brenda rajoneve, zonave informale për legalizim dhe urbanizim. U duhet dhënë rëndësi punëve të vogla jetike për qytetarët, pra fasadave. Vlorë duhet të kthehet në një qendër kombëtare historike, duke harmonizuar periudhat historike me llojet e turizmit ekologjik, bregdetar. Porti i Vlorës nuk është as për turizëm dhe as për mallra, nuk ka një markatë peshku, gjelbërimi është në shifra alarmante 0,7/m<sup>2</sup> nga 7/m<sup>2</sup>, që është standardi. Rrugët komunikuese me rivierën janë një kalvar vuajtjesh për pushuesit etj.

Nëse në një mandat të dytë nuk do të konkurronit sërish ose nuk do të fitonit, a do t'i riktheheshit detyrës suaj të mëparshme?

Besoj se po. Kam investuar shumë për profesionin e studiuesit. Do të mbaj si pedagog i jashtëm lëndën e Gjuhësisë teorike. Sigurisht, me sa do të kem mundësi, edhe do të shkruaj apo do të marr pjesë në tubime shkencore. Nëse nuk do të kem angazhim të drejtpërdrejtë si deputet, do të vazhdoj si tani.


**Në rolin e deputetit çfarë do të bëni për arsimin, duke qenë se jeni profesor? Keni ndonjë plan lidhur me këtë?**

Unë këtë problematikë e njoh mirë në të gjitha nivelet e arsimit: si profesor, si autor teksteesh, si drejtues, si hartues politikash arsimore etj. Do të kontribuoj nëpërmjet politikave konstruktive për një strategji arsimore, që është e lidhur me strategjinë e zhvillimit dhe të punësimit. Sistemi arsimor duhet shkuduar nga mbingarkesa me informacion të vjetruar dhe të pancevojshëm, në mënyrë që fëmijët dhe të rinjtë tanë të kenë kohë për të menduar dhe jo të mësojnë për rriproduar. Buxheti për arsimin është më i ulët në Evropë, nuk shkon as 3% e PBB-së, ku universitetet marrin vetëm 0,5%. Për shkencë shpenzohet më pak se 0,17%. Brenda arsimit të lartë buxheti për shkencë nuk arrin as 1%. Buxhetimi për arsimin e lartë nga shteti nëpërmjet fondit të pakushtëzuar nuk mjafton as për 10 muaj rrogë. Taksimi i lartë i profesorëve ka ulur ndjeshëm të ardhurat e tyre, deri 25% më pak se 4-5 vite më parë. Investimet në arsim nuk kanë shkuar në proporcion me dinamikën e zhvillimit dhe demografinë e zhvendosjes së popullsisë. Cilësia në arsim është sfida e jonë e përmbashkët.



## ZAIMINA përgënjeshtro shtatzëninë Këngëtarja poston foton seksi

Zaimina Vasjari, një nga këngëtarët më të përfolura të kohëve të fundit është shpëputur nga pushimet dhe po vazhdon punën intensive për promovimin e veshjeve të biznesit të saj nëpërmjet fotove në rrjetet sociale. Zaimina duket në superformë dhe me linja perfekte. Ka kohë që aludohet për një shtatzëni të mundshme të bukurshes. Këngëtarja në foton e fundit që ka postuar në "Instagram" përveçse duket tërheqëse, nuk i lë vend syrit të fansave për të hequr kureshtjen, nëse po pret apo jo fëmijë. Nuk e dimë në është e qëllimshme fotoja ku thuhetse barku nuk duket. Të gjithë sytë nga Zaimina për konfirmimin e lajmit.



## Heq rrobat e juristes Ja si duket Eni Çobani në plazh

Eni Çobani është bërë gati për të shijuar verën. Juristja e njohur e seanceve ndërmjetësuese të rubrikës "Shihemi në gjyq" ka filluar pushimet. Ajo ka preferuar t'u largohet të gjitha kornizave që e mbanin të lidhur me emisionin. Në një foto postuar në "Instagram", Eni duket se po u buzëqesh ditëve të lumtura të verës së nxehtë. Ajo shkruan: "Larg zhurmës dhe rrëmetit, pranë detit - thonë - si pranë mbretit. Pushim dhe qetësi ju uroj të gjithëve". Juristja e dashur nga të gjithë duket tejet e ëmbël me rroba banje dhe me të qeshurën e bukur në fytyrë.




## MEDIAT SERBE: Shqiptari ngacmoi modelen serbe dhe u rrah nga miqtë e saj

"ALO": MË PAS DJALI NGA SHQIPËRIA  
U DETYRUA T'I DHURONTE NJË JAHT



Modelja serbe, Starleta Tamara Djurić, e cila këto ditë po pushon në Budva, paska shkaktuar "trazira". Mediat serbe shkruajnë se një shqiptar i është vardisur asaj gjatë argëtimit të natës. Mesa duket, shqiptarit i ka dalë huq i gjithë mundi. Meshkujt të cilët e shoqëronin Tamarën e kanë rrahur shqiptarin që guxoi t'i afrohej asaj. Bëhet me dije se shqiptari i ka kërkuar falje modeles dhe i ka dhënë jahtin e tij si dhuratë. Zërat nga ata që kanë parë çka ndodhur mes shqiptarit dhe modeles thonë se pasi djali ishte tërhequr shumë nga serbja seksi, ishte afruar ta ngacmonte atë, por miqtë e saj e kishin rrahur. Mirëpo, sipas këtyre fjalëve, të nesërmen shqiptari iu është afruar miqve të Tamaras dhe iu ka kërkuar falje. Siç bën me dije gazeta prestigjioze serbe "Alo", më pas shqiptari i ka ftuar në jahtin e vet, por me kusht që ta sjellin edhe Tamarën. Shqiptari i kishte kërkuar falje dhe i ka thënë se dëshiron t'ia falë jahtin që ajo të pranojë faljen. Tamara e kishte falur, por dhuratën e kishte refuzuar. Zëra të tjerë thonë se Tamara qenka zemëruar me miqtë e vet sepse e kanë sjellë atë në jahtin e shqiptarit. Për këtë madje e paska ndërruar hotelin që të mos takohet me miqtë. S'e dimë sa të vërteta janë këto lajme, pasi bukurshja serbe nuk ka dhënë asnjë prononcim për "incidentin" e ndodhur.



## Kë po "kërcënon" me gërshërë në dorë deputetja e PS-së?!

Deputetja socialiste, Ledi Shamku, ka lënë jo vetëm Parlamentin tashmë, por edhe auditorët e studentët e saj, në Itali për të marrë disa ditë pushime. Po ajo nuk ka shkuar në plazh, por e shohim më gërshërë në dorë, duke prerë barërat e këqija në një shesh apo lulishte. Ledi Shamku Shkreli ka postuar në "Facebook" një foto, ku shfaqet me gërshërë të hapura dhe gati për të prerë diçka. E ndërsa miqtë e pyesin se kë po "kërcënon" në atë mënyrë me gërshërë, ajo shprehet duke qeshur se po kërkon të presë të gjitha ato barëra, ose bimë që janë rritur pa lejen e saj.



## Erion Veliq bëhet nostalgjik, si i kaloi dy vjet në krye të bashkisë

Kreu i Bashkisë Tiranë, Erion Veliq mbushi dje zyrtarisht 2 vite si qytetari numër 1 i kryeqytetit. Këtë ditë shumë të rëndësishme për të, Veliq e ka përkujtuar në rrjetet sociale. Ai e kujton si një nga më të rëndësishmet në jetën e tij, duke i cilësuar këto 2 vite, si dy vitet më sfidues të jetës së tij. Duke e nisur me një falënderim për të gjithë, Veliq shkruan, ndërsa poston foto nga punët më kryesore që janë bërë në Tiranë në dy vjet: "Dy vite më parë, pas betimit e rregullimit të Sahatit, nisëm punën për ta çuar Tiranën në drejtimin e duhur me mbështetjen e secilit prej jush! Kanë qenë dy vitet më sfiduese të jetës time, ju jam mirënjohës nga zemra!".



# BULEVARDI POLITIK

Nga merrni seriozisht! 😊



## Historia e teshtimës në fjalimin e Enver Hoxhës

Në ishte një herë Enveri dhe po mbante fjalim para popullit. Në pikën më kulmore të fjalimit dëgjohej një teshtimë e fortë nga populli.

- Kush teshtiu? - pyeti Enveri plot nerva.

Asnjë nuk foli, por Enveri nguli këmbë disa herë pa marrë përgjigje, derisa nga acarimi dha urdhër që 50 vetë nga populli të pushkato-heshin menjëherë. Urdhri u krye direkt.

- Kush teshtiu? - pyeti Enveri për të disatën herë dhe në kulmin e nervave. Askush nuk përgjigjej.

- Edhe 50 të tjerë, urgjent! - ulëriti ai.

Urdhri u krye në vend. Një plak rreth 90 vjeç vendosi ta merrte vetë përsipër teshtimën duke marrë parasysht moshën dhe kasaphanën që mund të ndodhte nëse ngjarjet do vazhdonin kështu.

- Kush dreqin

teshtiu? - ulëriti çmendurisht Enveri.

- Unë, - tha plaku me gjysmë zëri duke ngritur dorën i penduar në maksimum.

- Shëndet! - ja kthen qetësisht Enveri.



## Historia që u tregoi Rama deputetëve: Si arriti Nastradini tek e vërteta

Një ditë, në një nga mbledhjet e grupit parlamentar, kreu socialist po u shpjegonte deputetëve se si ishte puna që ai i kërkonte çdo herë kryeministrit të mos gënjehte në publik, por të thoshte të vërtetën. Deputetët gjithë sy e veshë po dëgjonin. Dhe Rama u tregon një histori me Nastradinin: Nastradini qëndroi në pazar dhe filloi t'u drejtohej turmave të njerëzve që ishin aty:

- O njerëz! Doni dije pa vështirësi, të vërtetën pa gënjeshtër, arritje pa përplekje, përparim pa sakrificë?

- Po, Po!

- Mrekullii! - Tha Nastradini. - Doja vetëm ta dija. Mund të bazoheni tek unë, se do t'ju them mënyrën se si mund të arrihen këto gjëra, nëse do të zbuloj diçka të tillë, ndonjëherë. Dhe pas kësaj historie, të gjithë deputetët ranë në mendime.





Senad Nikshiqi

SHKODËR

Shpresa Kopliku është pacientja e kirurgut Besmir Grizhja. Mjeku u godit tri ditë më parë nga bashkëshorti i saj (pacientes) Ali Kopliku (është në kërkim), me pretendimin se nuk ka firmosur rekomandimin që gruaja e tij të marrë me rimbursim një ilaç të shtrënjtë. Dje, Shpresa Kopliku hodhi poshtë pretendimet e spitalit të Shkodrës, por edhe të vetë mjekut Grizhja, i cili një ditë më parë deklaroi se Aliu nuk ia blinte ilaçet gruas së tij dhe se ai e ka ndihmuar disa herë të sëmurën. Ajo tha për "Gazeta Shqiptare" se prej 3 muajsh e blen vetë këtë ilaç, vetëm se kirurgu nuk ka firmosur rekomandimin.


PACIENTJA

"Kam 5 muaj që më trajton kirurgu Besmir Grizhja. Kam qenë shumë keq. Kam shkuar edhe në Tiranë, por atje më thanë se 'e ke mjekun në Shkodër', ndaj dhe erdha këtu. Unë kam vënë protezë dhe më ka rënë trombozë. Është një ilaç që unë e marr me rimbursim. Marr rekomandim të mjekja e lagjes dhe kirurgu që më ka trajtuar. Kam tre muaj që këtë ilaç nuk e marr më, por e blej. Kam faturat dhe letrat e doktorëve të Tiranës që këtë ilaç prej tre muajsh e blej. Vetëm një kokërr bën 350 lekë të rinj. Unë kam vetëm 78 mijë lekë të vjetër KEMP burrin invalid, edhe ai me KEMP, ndërsa kam dy fëmijë, një 5 vjeç dhe një 4 vjeç. Unë nuk i kam kërkuar asgjë kirurgut. Nuk i ka bërë askush presion asnjëherë. I kam kërkuar që të plotësojë rekomandimin siç e kërkon

Burri i pacientes, SMS mjekut: Ka xhenet, ka xhehenem, kije frikë Zotin!

# "Kirurgu Besmir Grizhja gënjen, kam tre muaj që e blej ilaçin vetë"

Shpresa Kopliku: Kam faturat e doktorëve të Tiranës



Shpresa Kopliku duke folur për "GSH"



Faksimile e SMS-së

Tirana në mënyrë që të marr ilaçin me rimbursim, por ai nuk e ka bërë këtë gjë prej tre muajsh. Ai është kirurg dhe duhet ta dijë. Nuk më ka dhënë asnjë arsye se përse nuk e firmosur rekomandimin. Unë jam kthyer nga Tirana dy herë vetëm prej tij, vetëm se nuk e plotëson këtë rekomandim. Te Ministria e Shëndetësisë dhe në QSUT jam ankuar sepse jam kthyer mbrapsht dy herë për faj të kirurgut Grizhja", - u shpreh Shpresa Kopliku. Pacientja deklaroi se kirurgu Grizhja

REAGIMI I MJEKUT

Dy ditë më parë, kirurgu i dhunuar, Besmir Grizhja deklaroi për "Gazeta Shqiptare" se e ka ndihmuar disa herë pacienten Shpresa Kopliku, duke ia blerë ai vetë ilaçet, pasi bashkëshorti i saj, Ali Kopliku nuk ia siguronte ato.

nuk i ka blerë ilaçe nga xhepi i tij siç ka deklaruar. "Besmir Grizhja nuk më ka blerë asnjë ilaç, por i kam blerë vetë. Më kanë dhënë vetëm serumin 24-orësh, të tjerat i kam blerë vazhdimisht vetë. Nuk është fare e vërtetë, kurrë s'më ka blerë vetë ilaçe dhe

këtë e ka gënjeshtër. Ai mund të thotë çfarë të dojë, por unë jam pacientja".

SMS-ja E BURRIT TË PACIENTES

Ndërkaq, Shpresa Kopliku tha se burri i saj, Ali Kopliku i ka dërguar një mesazh në celular kirurgut Besmir

Grizhja ku i thotë se: "Ka xhenet, ka xhehenem. Po të pata ra në qafë, trupi im i pagoftë, po më pate ra në qafë e po më sorollat, tallesh me mua dhe familjen time, ke për t'i paguar keq. Ti vazhdo, po kije frikë Zotin dhe jo mua". Kjo SMS ka acaruar më pas situatën mes tyre. "Burri im i ka dërguar një mesazh krejt normal. Pas mesazhit, kirurgu e ka marrë në celular dhe nuk e di se çfarë mund të kenë folur, por kam dëgjuar bashkëshortin tim që i ka thënë se, 'në qofsh burrë, këto fjalë eja dhe m'i thuaj në sy përballë'. Te lulishtja e rrugicës së spitalit janë takuar bashkëshorti im dhe kirurgu. Nuk kam dalë nga makina fare. Di vetëm kur bashkëshorti më ka ardhur me gjak në buzë dhe në fytyrë i goditur. Sipas asaj që është thënë lart e poshtë, kirurgu është goditur nga burri im dhe për këtë nuk është me mua. Në fakt, bashkëshorti kur erdhi më tha se për shkak të mesazhit që i ka dërguar ishte mjeku Grizhja ai që i ka rënë i pari. Tani bashkëshorti nuk është me mua dhe nuk e di ku ndodhet, ndërsa unë jam vetëm. Nuk ka kush më blen ilaçet", - u shpreh Shpresa.

## Përparim Çela: Kemi kërkuar që të ketë policë në spital

### Dhuna ndaj kirurgut, drejtori i spitalit: U godit një mjek i talentuar, dënojmë aktin!



Drejtori i spitalit, Përparim Çela



Kirurgu, Besmir Grizhja

operacione të rralla dhe shumë të vështira, ku në kushtet e sotme kryhen vetëm në klinikat e specializuara, duke u ardhur kësh-tu në ndihmë pacientëve të qytetit të Shkodrës. Patjetër që na duhet mbështetje nga policia, dhe nga drejtoria e policisë në ësh-

të premtuar shumë shpejt që efektivet do jenë në spital", - tha drejtori Përparim Çela. Ndërsa mjekja Nevila Tabaku, përfaqësuese e Urdhrit të Mjekut në Shkodër, pohoi se deri më tani nuk ka asnjë person të dënuar për dhunën ndaj mjekëve. "Me keqardhje themi se

deri tani nuk kemi konstatuar që të jetë dënuar ndonjë person për dhunën e ush-truar herë pas here ndaj mjekëve apo ndonjë masë tjetër në mbrojtje të tyre. Nisur nga rasti i fundit dhe si një vijimësi e këtyre rasteve të përsëritura, protestojmë dhe shprehim indin-

datën më të thellë, duke kërkuar nga strukturat e shtetit ndëshkimin e dhunës të mjekut dhe marrjen e masave në rivendosjen e dinjitetit të mjekëve dhe personelit mjekësor", - deklaroi Tabaku. Sindikata e Shëndetësisë, përmes Paolo Kacerit fajëson shtetin se mjekët nuk kanë mbrojtje. "Dënojmë dhunën kundrejt bluzave të bardha. Mund të jetë një veprim individual, por në këtë rast është edhe shteti që i ka rënë mjekut, për arsye se rastet po denoncohen një pas një dhe asnjë masë nuk po merret për mbrojtjen e bluzave të bardha. Ka edhe një mungesë organizimi, sepse duhet të ketë më shumë qartësi për mjekët e gatshëm dhe mënyrën se si funksionon, sepse këtu të gjithë i duan gjërat urgjente, por askund në botë për çdo gjë s'ka shërbim urgjent në mjekësi", - tha Paolo Kaceri.

**Qytetari i ankolet Ramës, Bashkia: Gruaja e tij konkurroi me të afërmit për vendin e punës**

**PËRMET** - Dëgjuesat publike janë kthyer në mundësinë më të mirë të qytetarëve për të shprehur ankesat e tyre ndaj drejtuesve vendorë. Albert Brahollari ka qenë qytetari nga Këlcyra që iu ankua kryeministrit Rama gjatë dëgjësës në Gjirokastrë me pretendimin se konkursi e zhvilluar për vende pune janë fiktive dhe nuk respektohen. "GSH" ka komunikuar me të dyja palët e këtij konflikti, shtetasin Brahollari dhe kryebashkiakun e Këlcyrës, Klement Ndoni. Brahollari pretendon se e shoqja është shpallur fituese e konkursit të organizuar nga DPGJC në vitin 2012, mes 4 kandidatëve pjesëmarrës në konkurs. Sipas tij, pavarësisht kësaj, Bashkia Këlcyrë refuzon të punësojë fituesen e këtij konkursi, duke mos respektuar rezultatin e konkursit. Krejt ndryshe e paraqet situatën kryetari i Bashkisë, i cili pohon faktin se në 2012-ën është zhvilluar një konkurs për vendin vakant të punonjës së gjendjes civile në këtë bashki, pas largimit të punonjës së mëparshme për shkelje në detyrë. Ndoni sqaron se konkursi, i rregullt në pamje të parë, u zhvillua nga DPGJC në Tiranë, prej nga dalin dy kandidatura pretendente për vendin e punonjës të Gjendjes Civile. Sipas Ndonit, shtetasi Brahollari kishte ndërhyrë duke shfrytëzuar njohjet personale në DPGJC për të regjistruar si konkurrent, të shogon, mbësën, burrin e mbesës dhe një kushëri të gruas. Pra katër familjarë që konkurrojnë për një vend pune. Në përfundim shpallen fitues bashkëshortja e Brahollarit dhe burri i mbesës. Ky i fundit tërhiqet nga kandidatura për vendin e punës, duke kërkuar që të mbetet vetëm znj. Brahollari, që automatikisht duhej të punësohej në Zyrën e Gjendjes Civile. Bashkia Këlcyrë zhvillon një hetim administrativ, ku bën verifikimet e nevojshme, duke vërtetuar marrëdhënien familjare të kandidatëve për të njëjtin vend pune. Në këto kushte, DPGJC shpall të pavlefshëm konkursin, duke rrefuzuar automatikisht kandidaturën e shpallur fituese për vendin e punonjës të zyrës së gjendjes civile. Por pavarësisht vendimit të fundit të DPGJC dhënë në 2013-ën, Albert Brahollari vijon të kërkojë të drejtën ligjore dhe vendin e punës së bashkëshortes së tij. Ainuk pranon asnjë prej pretendimeve tashmë të faktura të Bashkisë Këlcyrë. Prezantimi i ankesës së tij para kryeministrit Rama ka qenë tentativa e fundit e shtetasit Brahollari, që vijon të quajë si të vlefshëm konkursin tashmë të skualifikuar nga vetë DPGJC-ja, e cila është detyruar të pranohet gabimet e veta pa ripërsëritur konkursin. Aktualisht, Zyra e Gjendjes Civile në Këlcyrë vijon të ketë si të punësuar një punonjës të komanduar. **br.me.**

## SHKOLLA E BASHKUAR "SKËNDERBEJ" LIBRI

"Skënderbegasit ndër vite", libri i autorëve Maksim Fejzulla e Kujtim Boriçi

# Arkivi i Shkollës së Bashkuar, kush ka dhënë mësim në 45 vite

"Nxënësit që studionin në shkollat civile dhe atë të muzikës"

**S**hkolla e Bashkuar apo siç njihet shkolla e "begsave" ka qenë një ndër institucionet e rëndësishme të arsimit. Në 45 vite të funksionimit të Shkollës së Mesme të Përgjithshme Ushtarake "Skënderbej", në të, kanë punuar qindra mësues, pedagogë, ushtarakë dhe punonjës të shërbimeve të ndryshme. Në Arkivin Qendror të Ministrisë së Mbrojtjes ruhen regjistrat themeltarë, dosjet përkatëse, së fundi dhe të dixhitalizuara, burime të cilat kanë shërbyer për hartimin e listës në vazhdim. Por fatkeqësisht, për shkak të dëmtimit dhe pakujdesisë së rrajes ndër vite, ky fond i arkivit nuk është i plotë. Në të ka edhe mungesa të personave që kanë punuar në këtë shkollë. Në këtë pjesë të parë të shkëputur nga libri "Skënderbegasit ndër vite" i autorëve Maksim Fejzulla e Kujtim Boriçi në do të sjellim pikërisht dy pasazhe interesante nga Shkolla e Bashkuar, kontingjentet që studionin në shkollat e Tiranës, për nxënësit e shkollës së muzikës si dhe lista me emrat e pedagogëve në 45 vite të kësaj shkolle.

### SHKOLLA "SKËNDERBEJ", KONTINGJENTET QË STUDIONIN NË SHKOLLAT E TIRANËS

Shkolla Ushtarake "Skënderbej" nuk ka qenë vetëm shkollë që përgatiste ushtarakë të mirëfilltë, pilotët, këmbësorët, xhenierët, kimistë, nëndërlidhësit, kimistët, topografët, oficerët të ardhshëm të ushtrisë, porë dhe institucioni ku përgatiteshin me objekt qindra nxënësit që studionin në shkollat civile, kryesisht profesionale, me synim që nesër të shërbenin në sektorë të tjerë të ushtrisë e të institucioneve të tjera në vend. Kështu, janë shumë skënderbegas, që duke qenë kontingjentë të kësaj shkolle, të akomoduar në mjediset e saj, mësimet ditore i zhvillonin në shkollat

profesionale të kryeqytetit në degët ndërtim, inxhinieri, mjekësi, ekonomi, gazetari, kulturë, shkencat shoqërore etj...

Referuar arkivit të shkollës dhe dokumenteve që gjenden në Arkivin Qendror të Ushtrisë, kjo mënyrë ka nisur të aplikohet që nga shtatori i vitit 1964 e në vazhdim. Nga burimet e mësipërme mësohet se kontingjenti i skënderbegasve që studionin në shkollat civile të Tiranës ishte i organizuar në bazë kompanie. Kjo kompani, duke përfshirë të gjitha degët, kishte çdo vit mbi 100 skënderbegas. Komandant i kësaj kompanie në fillim ishte Koli Denek e më pas Dhanil Raveli, Fuat Çeliku e Ylli Themeli. Këta skënderbegas, i nënshtroheshin gjithë aktivitetit dhe orarit të veprimeve që kishin shkolla "Skënderbej", me përjashtim të procesit mësimor të paradites që zhvillohej nëpër shkollat e Tiranës. Çdo mëngjes, dy autobusë i merrnin këta skënderbegas nga shkolla "Skënderbej" dhe i dërgonte në shkollat përkatëse të Tiranës. Ndërsa pasdite, shkente dhe i merrte e i sillte në shkollë. Por për shkak të specifikës që kishin shkollat e Tiranës dhe numri i kufizuar i skënderbegasve që studionin në disa prej tyre, kishte skënderbegas që flinin dhe në konvikte e shkollave ku mësonin duke qenë ndërkohë gjithmonë nën përkujdesjen e komandës dhe drejtorisë së shkollës "Skënderbej". "Në kohën kur unë drejtoja këtë kompani, kishte mbi 100 skënderbegas që ishin shkollat e Tiranës dhe për ta kishin të njëjtin përkujdesje të veçantë, e sanksionuar dhe në urdhrat përkatës të komandës e drejtorisë së shkollës sonë. Ata studionin për mjekësi, ndërtim, kulturë, ekonomi etj. Kujtoj mes tyre Z. Arqile Lipe, deri vonë regjisor i estradës së Fierit, Ibrahim Bratin, Qemal Zylën, Ilir Gjylametin, Nuredin Fejza që u bë një mjek i njohur etj. Pasi diplomoheshin në shkollat civile e fakultete të ndryshme, këta skënderbegas punonin e drejtonin në sek-

torë specifik të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm, njësi e reparte të ushtrisë në spitale, ofiçina, Spitalin Ushtarak në Tiranë etj.", - pohon Ranil Raveli, ish-komandant i kompanisë.

Kjo praktikë vazhdoi deri në vitin 1968, kur në mjediset e Shkollës Ushtarake "Skënderbej" u hap dega elektro-mekanike.

Ne, nxënësit e Shkollës së Mesme të Muzikës "Skënderbej"

### ALFRED TARE

Në historikun e Shkollës së Mesme të Përgjithshme "Skënderbej" një vend me rëndësi, ndonëse funksionoi vetëm për tri vite, ka dhe Shkolla e Mesme e Muzikës "Skënderbej". Ajo, ndonëse ishte vendosur në mjediset e tjera, ishte pjesë e shkollës-mamë, Shkollës së Mesme të Përgjithshme "Skënderbej" dhe misioni i saj që tepër fisnik: Të përgatiste këngëtarë, artistë e profesionistë të fushave të tjera të artit, të cilët do të ishin në funksion të fushës së artit dhe edukimit në efektivitet e Forcave të Armatosura si dhe masave të tjera, që siç dihet, atë kohë cilësohej dhe vlerësohej "Gjithë populli ushtar".

Që në fillim, dua të theksoj se Shkolla e Mesme e Muzikës "Skënderbej", që do të ishte një shkollë elitë në fushën e artit, fatkeqësisht nuk i shpëtoi politizimit e ndëshkimeve në kuadër të luftës që shpërthoi në atë kohë kundër të ashtuquajturit "Grupi armiqësor në ushtri" i kryesuar nga Beqir Balluku". Unë kam qenë një nga skënderbegasit e parë të kësaj shkolle dhe ruaj mbresa të më të bukura për shokë, pedagogët tanë të mrekullueshëm dhe për gjithë atë që u bë atë kohë në këtë vatrë të edukimi.

Shkolla e Mesme e Muzikës "Skënderbej" u hap në shtator të vitit 1972, nën kujdesin e drejtpërdrejtë dhe urdhrin e firmosur nga Ministri i Mbrojtjes Popullore, Beqir Balluku. Në fillim, nga viti 1972 dhe me vitin 1973, ne ishim dy toga me nga 20 vetë secili, ndërsa në vitin 1974, në këtë shkollë u pran-

uan dhe 20 nxënësit të tjerë. Ndër themeluesit e kësaj shkolle, drejtor i parë i saj përmendet Selman Shtishi, një muzikant i njohur atë kohë si dhe një njeri i mrekullueshëm, me aftësi të spikatura profesionale, edukative dhe i palodhur. Ndër themeluesit e saj përmend dhe Tomorr Kurtin si komandant ushtarak dhe përgjegjës për anën muzikore Xhihan Xhihanin. Magazinier i shkollës ishte Meleqi dhe Myslymi, të cilët ne, brezi i skënderbegasve muzikantë, i kujtojmë edhe sot me dashuri dhe respekt. Më vonë erdhi komisar i shkollës Bashkim Myftari dhe dy oficerë të tjerë, Haxhiu dhe Myslymi, por kryesori në këtë shkollë, ishte Selman Shtishi. Në anën e përvetësimit të programit e atë muzikore, bëhej një punë e kualifikuar, me ngarkesë e që është vlerësuar maksimalisht në atë kohë. Në vitin 1973 ne e dhamë provinim e saxhos muzikore në prani të Beqir Ballukut... Ai na donte ne shumë e përkujdesje vazhdimisht për ne, aq sa them na njihite të gjithëve me emra. Ndërsa në vitin 1994, kur ne e prisnim që përsëri Beqir Balluku të ishte i pranishëm në provinim tonë, ai nuk erdhi. "Beqir Balluku nuk vjen se ai është në konvaleshencë...", - na thanë ne. Kujtoj se në provinim e këtij viti erdhën Xhemal Shehu, Vangjel Babi e disa të tjerë. Ne nuk e dimë se diçka e madhe do të ndodhte në ushtri e në jetën e vendit e për më tepër, që pëshpërtjet e dyshimet në atë kohë për këtë "grup armiqësor" kishin nisur.

Kështu, me dënimin e Beqir Ballukut si kreu i "Grupit armiqësor në ushtri", edhe kjo shkollë do të kishte fatin e keq, do të mbyllej. Bile, mbyllja e kësaj shkolle ishte ndër masat e para pas dënimin të "Grupit armiqësor në ushtri", pasi siç kam përmendur që në fillim, Beqir Balluku ishte ideatori dhe urdhëruesi i hapjes së Shkollës së Mesme të Muzikës "Skënderbej". Pra, dyert e kësaj shkolle u mbyllën në vitin 1975. Jo vetëm kaq, por ne po na quanin si "Djemtë e



Beqir Ballukut" e na shikonin shtrembër. Por jo vetëm kaq, por nuk na pranonin as në Liceun Artistik në Tiranë, ndonëse kishim studiuar kaq vite e ishim në prag të diplomimit. Ne u ndjemë keq... Mbay mend se ne, siç ishim, organizuam dhe një protestë para Ministrisë së Arsimit me parullën "Duam shkollë!". Na siguruan një takim për të na dëgjuar, ku mbay mend se ne na përfaqësoi trompisti Fisnik Toto dhe disa të tjerë. Më pas na syrgjynosën në ndërtesën e kurseve muzikore për kooperativat bujqësore. Në janarin e vitit 1976 hapën shkollën e re të baletit, ku mbaruam dhe atë vit shkollor që na kishte mbetur.

Dy klasat e tjera pas nesh, mbaruan në Liceun Artistik. Shkolla e Mesme e Muzikës "Skënderbej" u hap për herë të parë në Laprakë, atje ku kishte qenë më parë Batalioni i Sigurimit ose siç thirrej "Reparti i Diko Zeqos". Aty ishin edhe banda e ushtrisë, edhe Topografia Ushtarake.

### MËSUESIT, KOMANDUESIT DHE PUNONJËSIT E SHKOLLËS "SKËNDERBEJ" (VITET 1945-1992)

Në 45 vite të funksionimit të Shkollës së Mesme të Përgjithshme Ushtarake "Skënderbej", në të kanë punuar qindra mësues, pedagogë, ushtarakë dhe punonjës të shërbimeve të ndryshme. Në Arkivin Qendror të Ministrisë së Mbrojtjes ruhen regjistrat themeltarë, dosjet përkatëse, së fundi dhe të dixhitalizuara, burime të cilat kanë shërbyer për hartimin e listës në vazhdim. Por fatkeqësisht, për shkak të dëmtimit dhe pakujdesisë së rrajes ndër vite, ky fond i arkivit nuk është i plotë. Në të ka edhe mungesa të personave që kanë punuar në këtë shkollë. Në këto kushte, përveç listës së saktë zyrtare të mësuesve, oficerëve e punonjësve të afruar nga drejtuesit e Arkivit Qendror të Ushtrisë, ne jemi përpjekur që të shtojmë shumë nga personat e munguar, mbështetur në dosjet e tyre zyrtare që gjenden në

drejtorinë përkatëse të Ministrisë së Mbrojtjes apo dhe në Institutin e Sigurimeve Shoqërore. Por gjithsesi, për shkaqe të kuptueshme, kjo listë e pasuruar, mund të ketë përsëri mungesa. Në pjesën e tretë të librit "Skënderbegasit ndër vite...", shpresojmë të plotësohen këto mungesa...

### EMRAT E PEDAGOGËVE NË 45 VITE TË SHKOLLËS SË MESME TË PËRGJITHSHME USHTARAKE "SKËNDERBEJ"

- Ali Muharrem Neviri, mësues
- Anastasi Dhame Pile, mësuese
- Aferdita Neki Leskaj (Çepani), mësuese
- Asimiq Miso Proko, mësues
- Avdi Xhuglini, mësues
- Ana Ndoc Prifti, mësuese
- AndonVasi Gjymshana, mësues
- Ana Palok Ngjeçi, mësuese
- Aleksander Efim Dheri, mësues
- Arta Leka (Raveli), mësuese, administratore
- Andrea Jani, mësues, marangoz
- Ali Kasmi, mësues
- Asim Proko, mësues
- Aleksander Gjollma, mësues
- Ali Kasrati, mësues
- Aqil Muça, oficer
- Agim Çela, mësues
- Abaz Balla, oficer
- Agim Hasan Poturi
- Asime Petrel Asllani
- Agim Tepelena, komisar shkolle
- Agim Cerga, mësues
- Azife Murati, punonjëse
- Aishe Kola, punonjëse
- Adriatik Kallulli, Mësues
- Andrea Renxa, oficer
- Arsini Gjodeshi, mësuese
- Ali Meçe, oficer
- Anisa Tane, mësuese
- Agime Çela, mësuese
- Afrim Karagjozi, mësues
- Androkli Vaso, oficer
- Asqer Petani, oficer, mësues
- Abdi Lika, ushtarak
- Adil Lika, ushtarak
- Aferdita Hysa, mësuese
- Alma Dymishi, mësuese
- Aferdita Cobani, mësuese
- Astrita Taçi, mësuese
- Aida Beljeri, mësuese
- Aldo Milla, mësuese
- Anastasi Starakosha, mësuese
- Agron Nanaj, mësues
- Aferdita Çepani, mësuese
- Anton Maziqi, mësues
- Aslan Barret, kuzhinier
- Agron Leza, punonjës
- Albina Sevrani, punonjëse
- Ardian Sula, punonjës
- Agron Jonuzi, punonjës
- Afrim Melohu, punonjës
- Aferdita Beçi, punonjëse
- Aldy Ferra, punonjëse
- Aslan Shkreta, punonjës
- Agim Bimbiti, mësues
- Agron Shabani, ushtarak
- Agron Xhemali, ushtarak
- Avdi Sula, ushtarak
- Arben Haxhia, ushtarak
- Artan Gjika, shëndetësi
- Arben Singjeli, mësues
- Agim Sula, mësues
- Artur Brahimaj, mësues
- Alqi Kallço, mësues







Opinion i Ditës

# Mjeda pas 80 vitesh... heshtja nuk ka vend...!

Nga Përparim Kabo


(Vijon nga faqja 1)

... poet" dhe mund të ikë nga ngjarja dhe kujtesa si pa të keq... Ka punë ndoshta, ose e ka të mbështetur skedën e mendjes me të tjera të dhëna, shumë më "serioze". Po e lë në ikjen e tij... Unë po ndalem të them ato që ndjej dhe që besoj se duhet të ketë si dinjitet, edhe respekt ky përvojës. Fillimisht po ndez një qiri të madh për këtë mendje të ndritur dhe shumëplanësore.

Tek e sheh të heshtur në foto thua, po kush është ky? Të lutem fol, shpreh, thuaj diçka për të sotmen tonë, për Shqipërinë, për kulturën, për traditën, për historinë. Thuaj diçka që të shpërndash mjegullën, të davaritësh keqkuptimet dhe shtrembërimet që janë aq të kudotakuara sot. Thuaj diçka o njeri që të kuptohet se sa shumë padije dhe dije-kallpe garkullon ndër ne. Ndal Dom Mjeda atje të poezia jote lapidare "Vorri i Skënderbeut" (varri i Skënderbeut). Nga ai hon po mujte Ndre Shqypitari na i nis mësimet sepse edhe pas kaq kohësh edhe në vorr ka që nuk e duan Skënderbeun. Ndre Mjeda, në vazhden e Rilindjes ngriti lart figurën e heroit kombëtar, si simbol bashkimi dhe burim besimi në fitore. ("Vorri i Skënderbeut", "Shqyptes arbore", "Bashkonju", janë disa nga poezitë e tij të hapura të këtij karakteri dhe të pathosit atdhetar).

Le të shohim më nga pranë se si e nxjerr identitetin shqiptar Mjeda në poezinë e tij. Fillimisht le të këqyrim gjuhën. Si atdhetar dhe filolog, ai nënvizon se kudo që të jesh dhe çfarë do gjuhë që të mësoh e sa do mirë që ta zotërosh atë, mendimi vjen nga brenda në gjuhën e memës, s'ka shteg tjetër. Muzikaliteti dhe aroma e saj tejkalojnë gjithçka. Kudo që të shkosh në për botë, malli dhe dhimbja, lotët dhe brenat janë në gjuhën amtare. Duke pranuar shumësinë e gjuhëve, kontributet e tyre kulturore dhe nevojën që ka njerëzimi dhe individi për to, në një dëshirë të paanë Mjeda të poezia e tij "Gjuha Shqypte" nuk ndalet të shkruajë për gjuhën shqipe si... "si dielli pa hije/për mua t'tanave iu del". Edukimi patriotik realizohet përmes historisë së treguar dhe ai zë vend tek njeriu sajë gjuhës së popullit tënd. Vetëm falë saj historisë rrefehet ashtu e plotë, e qartë dhe emocionale. Strofa kulmore në këtë poezi është ajo që shpreh unitetin kombëtar përmes gjuhës dhe mënjanimit i çdo ndarjeje dhe dallimi, përjashtimi apo urrejtje.

"Gek" e tokm' malsi jallia  
Jan' nji komb m' u da s' duron  
fund e maj' nji a Shqipnia  
e nji gjuh' t' gjith na bashkon...  
Ky studim historik që tejkalon vargun dhe që pasohet me strofën tjetër, ku autori paralajmëron malkimin për ata që me veprimet të mbrapshta dhe me shkrime keqdashëse nxisin pëshëllim, shtrembërim, keqkuptime dhe falsifikime e ngre lart figurën e Mjedës. Gjuha na bashkon, kjo është kambara që edhe pas 80 vitesh pa Mjedën, duhet ta dëgjojmë të gjithë. Debatet e hapura për dialektet, për standardin dhe standardin e ri, për nevojën për rishikime



dhe për korrigejme, pa dashur t'u dalë kundër, përkundrazi duke shprehur mbështetjen time që këto tema duhen diskutuar, tërheqim vëmendjen, po ku porosia e Mjedës duhet të jetë udhërrëfyese. Gjuha na bashkon të gjithëve si shqiptarë. Dashuritë e pjesshme janë gjithnjë të gabuara. Por edhe gjuhëtarët mos të mbeten peng të ideve të ngurta. Sa e bukur është gënishtja, sa muzikale, sa bukur shkruhet dhe sa melodioze shpërfaqet kur e ndërton fonetikën tingëllore të fjalës. E adhuroj, paçka që më origjinë dhe me AND jam jo nga veriu, jam jugor e më thëllë akoma. Mjeda aso kohe për çka nënvizon dhe që ka vlerë edhe sot, në çdo rrethanë e lidh ekzistencën e atdheut me gjuhën. Sot jemi shtet i pavarur, me institucione dhe me liri të fjalës, aq sa e kemi dhe se si e kemi. Shqetësim mbetet identiteti. Në globalizmin e asaj kohe Mjediane, vendin dhe popullin e rrezikonte zhdukja fizike, asimilimi zhbërës. Historia ka provuar se ka popuj dhe gjuhë që kanë humbur, janë shuar dhe fosilizuar, aq sa nëse për efekt studimi apo interesi gjithfarësh përpiqesh të merresh me to, mund të paragjykoresh se je duke shpenzuar kohën me dogjana pa vlerë. Në fakt, nuk është ashtu. Me gjuhët e humbura kanë humbur të dhëna konkrete, për epoka, histori, ngjarje, kontribute. Duke i ringjallur goftë edhe për efektë studimore është e mundur të bëhen krahasime, të nxirren në dritë-lidhjet, dallimet, ndërthurjet, vjetërsitë, ndihmesat dhe pengesat, të kuptohen fillësat dhe bashkëpunimet, të identifikohet se ç'është filluese dhe çfarë e përfutur falë bujarisë prej tyre. Shqipja është në këtë kuptim jo vetëm pasuri kombëtare, por botërore, nuk e di nëse një ditë dikush apo disa do kujtohen që të merren më seriozisht me të. Me

originën, kontributet, filozofinë dhe lashtësinë e saj. Globalizmi i sotëm është po aq i rrezikshëm me deidentifikimin dhe ndërtimin e komunikimit me gjuhë globale dhe me mjete të simbolikës dixhitale, aq sa në një studim tërhiqte vëmendjen se nëse edhe buzëqeshjen do ta nisim me SMS si ikonë, do harrojmë të buzëqeshim duke i privuar njeriut dhe njerëzimit një nga kënaqësitë më të mëdha dhe më të nevojshme. Gjuha shqipe është pasuria më e madhe që kemi, por edhe amaneti më i madh. Lojërat me të dhe ngjyrja e saj më hojta dhe me copëza fjalësh të huaja, keqpërdorimet në shkrime dhe mjetet audiovizive janë krime të rënda. Lexon sot dhe dëgjon njerëz të pandërgjegjshëm që sillen me shqipen më keq se më një dhurim. Ndalmi kokëbosh! Ndalmi të pagdhendur apo modernë daleboje! Pa dëgjuar se paku sot Mjedën çfarë shkruante!

E njat tok' që je tue gzuë  
e ke zan' t'ash sa mij' vjet  
shqiptaria, që mbet mblue  
sot nën dhe, edhe shqip flet  
Sa kumte ka kjo strofë?! Toka  
është mijëvjeçare, je autoktonë  
shqiptar, nuk je i ardhur, je në trojet  
e tua shqiptar. Të jep shpirtpe-  
zullim fjala "zan..." "e je zan...".  
Dhe më vjen në mendje shpjegimi i  
studiesit të shquar, Petro Zheji,  
në veprat e tij për ezoterizmin e  
shqipes me atë pasuri të rrallë të  
homonimeve, sepse në një rast  
merr si shembull pikërisht fjalën  
'zë' 'za', ose 'zën', 'zan'... dhe në një  
hark dalë nga qendra e simbolit  
tregon se si kjo fjalë merr shtatë  
të kuptime në gjuhën shqipe, çka  
nuk ndodh me gjuhë të tjera. Kum-  
ti Mjedës se "nëndheu flet shqip"...  
është një kushtrim i butë, që rre-  
zon edhe sot përtacësinë e shumë  
akademikëve që janë të dashuru-  
ar me tabutë, ndaj edhe tremben  
të hyjnë në portat e mëdha të dijes

ku studimet primordiale për shqipen, për simbolizmin dhe algoritmin simbolik të saj, si edhe për aforizmin filozofik të shqipes janë materie provepruese, që i bëjnë nder atij apo atyre që i/u qaset/qasen dhe ka/kanë kurajën ta studiojnë. Gjithkush që ikën nga kjo përgjegjësi nuk frigon askënd, veç hijen e vet, që edhe ajo ka kohë që ka nisur t'i shkurohet pa i marrë leje të zotit.

Trinia kushtruese e Mjedës është Gjuha-Atdheu-Liria. Tek poezia "Vaji Bylbylit" ka vargje shumë të ndjera, por dua të vë në pah disa ide që më bëjnë të ndalem më shumë se ana artistike apo ajo estetike e poezisë apo vargut të tij.

Kafaz ke qiellin...

Epsin pengim

E gjith' ku t'rreshket

Shkon fluturim...

Paçka se poezia ka një ngarkesë të një simbolizmi natyralist dhe romantikën e kohës të shekullit XIX, nuk është e vështirë që nën varg të lexosh dhe filozofi. Pse për Bylbylin, atdheu ka si kafaz qiellin? Pse jashtë atdheut edhe nëse je bylbyl, je në kafaz? Ja këtë porosi e paska lënë edhe Mjeda kaq paqtë dhe kaq qashtë. Në atdhe kënaqësia mund të pengohet vetëm nga një lloj teprimi (epsin pengim)... përpos kësaj, pengesa që duket etike gjithçka është liri, je ti dhe atdheu yt. Tek poezia "Liria", Mjeda është më i drejtpërdrejtë, kushtron dhe bën thirrje për liri pa bërë as edhe një rregullim hapësinor, sepse gjeografia e lëvizjes është e tillë, që përfshin trojet etnike. Liria e tij me një patosh natyralist nuk ka askurëfarë panteizmi. Stili i tij është peizazhist dhe me dimensione epike. Të duket si një orakull i verbër, që këndon në lahutë ose thjesht në zë për të dhënë kushtrimin. Ai hyn maleve dhe grykave, rrjedh me ujërat dhe fle e zgjohet me malësorët dhe me epikën e detyrimet historike.

\*\*

Mjeda nuk mund të kalohet në heshtje, sepse nuk mund të heshtë vepra dhe aktiviteti tij. Ndre Mjeda, poet i shquar dhe veprimtar e patriot. Lindi në Shkodër nga i ati, Jakë Zefi (Kryeziu) dhe ëma Luçije (Domnika) Thaçi. I ati ishte me origjinë nga Mirdita, ndërsa e ëma nga Malci e Pukës. Si i ri me intelekt të zhvilluar, i talentuar dhe studioz, tërhoqi vëmendjen e jezuitëve, të cilët menduan ta bënin prof.

Në edukimin e tij patën ndikim shkrimtari jezuit Anton Xanoni (1863-1915) dhe poeti francezkan, Leonardo de Martino (1830-1923) Ai vazhdoi më pas studimet fetare në Spanjë, Itali e Poloni. Në fillim ndenji tre muaj, në pranverën 1880 në fshatin Cossé-le-Vivien afër Lavalit në perëndim të Francës, kurse më pas ndoqi një koleg në manastirin Kartuzian të Porta Coeli-t në veri të Valencias në Spanjë, ku studioi për letërsi. Kur shikon jetën e tij dhe sjell në mendje anatemin që sociorealizmi dhe ushtarët e tij u bënë jezuitëve dhe veprës së tyre gjatë periudhës

së diktaturës komuniste, e kupton se nuk është fjala për njerëz dhe fate, por për historinë tonë kombëtare dhe sjelljen ndaj saj. Eh sa gjynahe ka mbi shpinën e ndërgjegjes së gjuhëve të helmuara, që shërbyen ndaj sistemit të tij ndaj atdheut dhe dinjitetit të tij dhe sot qahen e ankohen si të lodhur nga fati.

Ndre Mjeda filloi të shkruajë poezi shqip nga fundi viteve '80-të të shekullit XIX, ndër to edhe jershsh melankolike mjaft të lexuar "Vaji i bylbylit", botuar më 1887 në broshurën "Sachiri Eliezy" (Poeti i nderuar), ku shpreh mallin për vendin e tij. Po e kësaj periudhe është vjersha "Vorri i Skanderbeut". Tema e shqiptarit në mërgim, që e merr malli për atdheun nën zgjedhjen turke, ishte më se e zakonit në letërsinë e Rilindjes, si domos në dhjetëvjeçarin pas dështimit të Lidhjes së Prizrenit. Edhe shumë vjersha të tjera nga pena e tij u kushtohen temave të tilla kombëtare. Por në poezinë e Mjedës ndihet ndikimi jo vetëm i kulturës rilindëse të kohës, por edhe i mësuësit të tij, Leonardo De Martino, poetit katolik shkodoran, përmbledhja poetike e të cilët i përpunuar bukur me 442 faqe e në dy gjuhë "L'Arpa di un italo-albanese" (Harpa e një italo-shqiptari) kishte dalë në Venetë më 1881. Po aq qartazi ndihet në vargun e Mjedës edhe ndikimi i poetëve bashkëkohës të Italisë: atdhetarit Xhozue Karducci (Giosue Carducci, 1835-1907), meditesit Xhovani Paskoli (Giovanni Pascoli, 1855-1912), të ndjeshmit Gabriele D'Annunzio (Gabriele D'Annunzio, 1863-1938) si dhe i letërsisë latine të lashtësisë klasike.

Nga 1887 deri më 1891 Mjeda dha mësimë muzike në kolegjin "Marco Xhirlamo Vida" (Marco Girolamo Vida) në Kremona buzë lumit Po, qytet i kompozitorit Kludio Monteverdi (1568-1645) dhe i Antonio Stradivari (1644-1737). Atje dhe në Soresina ai vazhdoi të shkruajë poezi e njëkohësisht iu përkushtua përkthimit të letërsisë fetare. Më 1888, Propaganda Fide në Romë botoi librin e tij "La vita et sceitit sc' Gnon Berchmans (Jeta e Shën Gjon Berchmansit), për një shenjtor jezuit nga Brabantit (1599-1621), kurse më 1892 botoi "T'perghjamt e Zojs Bekume" (Përngjasim i Zojs së Bekume), përkthyer nga spanjishtja. Më pas ai do të botonte një përkthim nga Katekizimi i madh në tri vëllime, "Historia e shenjtë" dhe një jetëshkrim të Shën Alojsius nga Gonzaga (1568-1591).

Nga viti 1891 Mjeda studioi për disa vjet në fakultetin teologjik të kolegjit Gregorian të Krakovit në Poloninë katolike. Atje u njoh me veprat filologjike të albanologëve Gustav Majer (Gustav Meyer, 1850-1900) dhe Holger Pedersen (1867-1953). Vjersha e Mjedës "Gjuha shqypte", e shkruar në dhjetor 1892, iu përkushtua gjuhëtarit austriak Majer, vepra monumentale e të cilët "Etymologisches Wörterbuch der albanesisches



Opinion i Ditës

Mekanizmi i veprimit të populizmit nuk është arsyeja, por llafollgjia

Tony Blair (ish-kryeministër i Britanisë dhe këshilltar i Edi Ramës, ref: "New York Times")

Nga Ferdinand Xhaferri

(vijon nga faqja 1)

...lista administratorësh, zyrtarësh dhe intelektualësh, që populli i ka denoncuar tek kryeministri. Shohim takime të kryeministrit me qytetarë, ku gra e burra bëjnë me dije problemet me hipotekat, legalizimet e kështu me radhë. Më pastaj reagon Edi Rama, që gjithë pasion vepron kundër drejtorëve abuzues me problemet e popullit. Populizëm i mirëfilltë, ku edhe mikrofoni se tek kush do të shkojë komandohet nga kryeministri. Dialogu në institucione dhe me shoqërinë civile nuk na bën punë, sepse ai është pjesë e elitave. Rama po i zgjidh hallet drejtpërdrejtë. Institucionet e liberal-demokracisë nuk janë më të dobishme. Kush do të tentojë të mospajtohet e ka vendin thjesht në kazan.

Ka një konsensus të studiuesve se individët që dashurojnë kartën e ndryshimit radikal të statuskuosë dhe ekspozojnë forcën individuale për t'u dhënë zgjidhje çështjeve të korrupsionit vetëm sa përfundojnë në forma më të këqija të përhapjes së tij. Për të provuar këtë konsideratë, ata ndalen me rastet e Hungarisë, Turqisë apo edhe më përtej deri në Amerikën Latine. Për këto vende organizatat e specializuara për të mbikëqyrur korrupsionin paraqitin rezultate që pasqyrojnë

chen Sprache (Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe) kishte qenë botuar një vit më parë në Strasburg. Veprat e Majerit dhe Pedersenit zgjuan te Mjeda interesimin për historinë dhe zhvillimin e gjuhës shqipe, që do të vazhdonte edhe në vitet e mëvonshme dhe do të kthehej në një ndihmesë për vetë problemin e alfabetit, nëpërmjet punës së tij me tekstet shkollore dhe studimet për autorët e vjetër katolikë, Pjetër Budi (1566-1622) dhe Pjetër Bogdani (rr. 1630-1689).

Më 1893 poetin e gjemjë në Goricia buzë kufirit italo-sloven, kurse pas një viti përsëri në Kraljevica, ku dha mësim filozofi e teologji e ku shërbeu si bibliotekar në kolegjin Gregorian. U emërua profesor i logjikës e më pas i metafizikës. Thuhet se më 1898, në gjirin e jezuitëve të Kraljevicës shpërtheu një konflikt, me sa duket për lidhjet e tyre me Austro-Hungarinë dhe me Vatikanin. Hollësitë e skandalit nuk njihen me saktësi, por dihet se Ndre Mjeda u përfshi nëfarësoj në këtë konflikt dhe menjëherë u përjashtua apo dha dorëheqjen atë vit nga Urdhri Jezuit.

Personalisht si autor i këtyre rreshtave nuk e di dhe as që dua ta di nëse institucionet tona i kanë dhënë ndonjë dekoratë këtij mendimtari dhe shqiptari të shquar. Unë e di me siguri që Dom Ndre Mjeda nuk ka nevojë për ne, ne dhe ardhmja jonë kemi shumë nevojë... për të!

Dom Mjeda, një meshë pendimi do kisha dashi' me e thir' sopy për Ju! Amin!

# Populizmi i Ramës dhe ambasadorët e Perëndimit



ecjen krah për kraht të korrupsionit me populizmin (Transparency International 2016).

Me populizmin e tij, Rama po përpiqet të përcjellë mesazhin se po sjell në qendër të vëmendjes ato çështje, të cilat i interesojnë qytetarin, por që zvarriten nga zyrtari. Deri këtu nuk kemi asgjë në kundërshtim me demokracinë. Por, populizmi i Ramës shkon më përtej dhe përjashton opinionet e kundërta dhe për rrjedhojë mohan legjitimitetin e kundërshtarëve politikë. Sikundër Rama është shprehur, atij nuk do i interesojë oponenca e opozitës në parlament, sepse ai është atje tek populli. Me këtë sjellje politike, Rama hedh në erë kulturën e debatit dhe respektin për opozitën, të cilat mundësohen dhe shprehen në Parlament. Në demokracinë sipas mendjes së Edi Ramës, çdo ditë e më pak do të përf-

shijmë elitat në hartimin e agjendave e çdo ditë e më tepër do të ripolitizojmë dëgjesat. Për më keq, mbas katër vitesh në qeverisje, dëgjesat publike që përfundojnë me shkarkesa, të lënë shijen se janë thjesht iniciativa zëvendësuese për të fshehur dështimin e reformave institucionale apo pafuqinë e Ramës për të luftuar korrupsionin në nivele të larta.

Ajo që duhet bërë në luftën kundër korrupsionit nuk është diskreditimi i administratës, që edhe pa iniciativat e Ramës është goxha e diskredituar, por fuqizimi i institucioneve demokratike. Përfundimi që mund të nxirret nga ekspertizat në çështjet e korrupsionit lidhet kryesisht me faktin se rrënjët e këtij fenomeni nuk qëndrojnë tek individit, por tek mosfunksionimi i shtetit dhe institucioneve të tij. Rama nuk duhet të pushojë arbitrarisht drej-

torë legalizimesh, por duhet të legalizojë institucione efektive kundër korrupsionit. Pra, të reformojë sektorin publik dhe të ndërtojë kapacitetet institucionale për t'i bërë strukturat shtetërore edhe më transparente edhe më efçente.

Tashmë që Rama është legjitimuar edhe nga një shumicë demokratike, ambasadorët e Perëndimit mund të jenë të vetmit aktorë që mund të kufizojnë turrravrapin populist të kryeministrit. Ata kanë qenë përgjithësisht të heshtur ndaj tendencave të shfaqura nga Edi Rama për të kontrolluar median dhe marginalizuar opozitën (Freedom House 2016 për punë të korrupsionit dhe përparimit të demokracisë na certifikon më keq se një dekadë më parë). Me këtë sjellje të tyre, ambasadorët Lu dhe Vllahutin, që janë në mbyllje të mandatit, do të lënë si hipotekë një Shqipëri në dukje të stabilizuar, por me shumë deficite lidhur me demokracinë. Pra, heshjtja e ambasadorëve të Perëndimit do të bëjë që në katër vitet që vijnë, në Shqipëri do të ndjehet gjithmonë e më pak fuqia e ligjit dhe gjithmonë e më shumë urdhri i kryeministrit. Kjo thjesht do të thotë se Shqipëria do të transformohet shumë pak nga ekspertiza e institucioneve, që formësohet nga argumentet dhe shumë nga retorika e Ramës, që formësohet nga populizmi. Pra, Shqipëria e populizmit të Ramës do të prodhojë politikë pa prodhuar politikë.

# Sqarim mbi pozicionin tim si psikologe

Anxhela Peza

Ditën e premtë në emisionin "Me zemër të hapur" u denoncu nga ana e gjyshit se mbesa 9 vjeçe dhe nipi 4 vjeç përdoreshin si lodra seksuale nga ana e nuses dhe të dashurit të saj në momentin që ata kryenin marrëdhënie seksuale. Ju bëj me dije se:

Ø Unë jam opinioniste e emisionit "Me zemër të hapur" në pozicionin e psikologes.

Ø Unë nuk publikoj video me dorën time në atë emision (është një staf i tërë që dakordon për gjëra të tilla).

Ø Unë nuk kam qenë psikologjia e rastit duke ndjekur fëmijët, por psikologjet e gjykatës. Jam ndeshur me këtë rast gjatë transmetimit ditën e premtë.

Ø Dhe jam krejtësisht e paanshme në opinionin tim.

Sot erdhi në studio babi i gruas. Pra, gjyshi nga ana mamasë dhe në linjë telefonike ka qenë nëna e fëmijëve.

Historia e dy të rriturve lakurijë së bashku me fëmijët brenda në krevat

Interesi më i lartë janë fëmijët

në çdo vend të botës. Ndërkohë që këta fëmijë janë në rrezik dhe gjykatat po e zvarrisin këtë çështje prej 8 muajsh, atëherë si duhet t'i shpëtojmë në fëmijët? Kam parë se disa janë indinjur tejet mase se përse vjehëri i nxori në shesh "imoralitetin" e nuses. Dyshime se mos babai në Amerikë ka krijuar një tjetër familje. Kunata nga inati i ka bërë video asaj. O njerëz, fëmijët brenda në krevat kur dy njerëz janë lakurijë ju bën sens?! Çfarë bëjnë dy të mitur, si reagojnë institucionet tona në mbrojtje të tyre. Ky është objektivi i çështjes. Ju mendoni se unë nuk menjdoj ashtu sikurse ju? Çfarë na duhen ne detajet e një drame kaq të madhe familjare, ash-tu sikurse njëkohësisht dua të jem edhe në dijeni për cka ndodh përreth. Nëse strukturat tona sociale do funksiononin siç duhet, atëherë nuk do ishte e nevojshme t'u binim dulleve mediaticë si për të shpëtuar jetë. Ju kujtoj vetëm këto rastet e fundit.

Ø Rasti i F. G., i cili abuzonte seksualisht me të miturën, rasti u bë publik.

Ø Rasti Fierit të javës së kaluar, një 12-vjeçarë dëshmoi live përdhunim e saj në një tjetër kanal

televiziv.

Ø Rasti i fëmijës që u dhunua nga drejtoresha e kopshtit barbarisht, duke parë dhe fëmijët e tjerë.

Ø Rastet e mësuesve që dhunojnë nxënësit në klasa.

Ø Rasti i Beratit, që fëmija ishte abuzuar 9 vjeçe dhe tani 12 vjeçe.

Nëse nuk do të ishte tërhequr veshi mediaticisht, atëherë këta do vazhdonin një ferr të vazhdueshëm. Ju mendoni se video do i shkatërrojë jetën, ndërkohë që memoria e tyre e përditshme dëshmon qartë, se nuk bëhet fjalë për një ditë. Video është pa fytyrë, pa emra, pa imazhe të qarta. Nëse në vendin tonë shpëtohen "jetë" duke thyer privatësinë, më mirë kështu. Por nëse disa prej juaj kanë parë keqardhjen se përse kunata në shtëpinë e saj ka filmuar nusen e vëllait duke kryer marrëdhënie seksuale brenda dhe fëmijët në shtat, atëherë kamufllimi humbet qëllimin prioritar.

\* Flet psikologjia Anxhela Peza për video-skandalin me fëmijët e molestuar seksualisht

## HOROSKOPI

**DASHI**  
Nëse jeni ende beqarë, ndoshta do të krijohen kushtet favorizuese për të bërë takime premtuese. Duke u dhënë më shumë hapësirë hobeve dhe krijimtarisë suaj, do të jeni më të gatshëm për të ndihmuar të tjerët.

**DEMI**  
Dielli së bashku me Hënën do t'ju vënë në provë. Do të zbatim duke bërë të shfaqen tensione, që zakonisht i mbani nën kontroll. Do të jeni të acarur dhe aspak tolerantë edhe ndaj keqkuptimeve të vogla me të tjerët.

**BINJAKET**  
Urani ju jep shumë energji, e cila është ideale për të dalë për t'u argëtuar me miqtë, por edhe për të ushtruar sporte të ndryshme. Do të dini gjithashtu edhe të gjeni një mes të artë midis dashurisë dhe punës, duke fituar admirim nga të gjithë.

**GAFORJA**  
Do të jeni autoritar dhe konkret. Edhe pse për shkak të kundërshtive të vogla, do të përjetoni momentet të mira e të këqija. Dorëzohuni përpara faktëve, zëmra ju rreh fort për një person të vegantë, që deri më tani e keni shpërfillur!

**LUANI**  
Në mjedisin e punës mund të ndryshojnë disa gjëra. Duhet të përballeni me sfida të reja. Është e fortë dëshira për të rilindur, për t'ia nisur nga e para. Është një ëndërr që mund të realizohet dhe e keni vetë në dorë për t'ia dalë. Varet nga vullneti i juaj.

**VIRGJERESHA**  
Strategjitë pak komplekse dhe pak të paqarta që po vini në zbatim nuk do të jenë më efikase se një linjë veprimi konkrete, e qartë dhe e saktë. Me Venusin dhe Marsin armiqësor qëndroni larg flirtimeve, që i bëni thjesht për inat.

**PESHORJA**  
Neptuni në bashkëveprim me Marsin do të nxistë prirjen për t'u mbyllur në vetvete, duke mos shfaqur emocione dhe ndjenja. Sot jeni të shpërgjendur dhe nervozë. Por, për fat, humori i keq është i përkohshëm dhe dielli do të ndriçojë!

**AKREPI**  
Me Plutonin ju shumë miqësor bëni kujdes me ata që nuk janë duke ju thënë të vërtetën. Nuk mund të bëni më sikur nuk e kuptoni, është koha për sqarime. Do të përfitorni nga një frymëzim nisëtar, që do të mbështetet nga fantazia dhe krijimtaria.

**SHIGJETARI**  
Sot do të keni të bëni më shumë me kënaqësinë se me punën. Do t'i zgjidhni çështjet e përditshme me efikasitet. Në çështjet e dashurisë, do të keni një lutë të brendshme midis dëshirës për t'u shmangur dhe nevojës për siguri.

**BRICJAPI**  
Nëse do t'ju duhet të përballeni me tekat e një familjari, jini të duruar. Mos bini pre e nervozizimi dhe përpiquni ta zgjidhni çështjen me urtësi. Të mendoni mbi atë që duhet të bëni do t'ju ndihmojë të qartësoni për rrugën që doni të vazhdoni të ndiqni.

**UJORI**  
Detryat dhe përgjegjësitë duhet të jenë një puntë të parë për ju, me Saturnin dhe Hënën që bashkëveprojnë duke ju mbështetur. Një mik me ndikim, me më shumë përvojë ose më i madh se ju, do t'ju ndihmojë të realizoni një ëndërr.

**PESHQIT**  
Është koha e duhur për të ndërtuar me vendosmëri dhe durim bazat për të zhvilluar më tej projekte të ndërmarrta. Do të dini të shqyrtoni në mënyrë të prerë dhe me zgjuarsi çështje shumë delikate dhe të rëndësishme që kanë të bëjnë me punën.

Taulanti nuk iu përgjigj as SMS-ve të italianit. Sjellja e tij, e papranueshme

# Skandali, Xhaka refuzoi të takojë Kristian Panuçin

## Trajneri e priti 3 orë pas ndeshjes mesfushorin



Jeton Selimi

**K**ristian Panuçi nuk është takuar me Taulant Xhakën, ndryshe nga sa u tha dhe u trumbetua një ditë më parë. Historia e re është praktikisht një skandal i ri në Kombëtare dhe duket se kësaj radhe Xhaka e ka kompromentuar përfundimisht karrierën e tij me fanellën kuqezi. Taulant Xhaka u largua nga përfaqësuesja pas disa përplasjeve që pati me ish-trajnerin Xhoni De Biazi, të cilat filluan që në takimin Zvicër-Shqipëri në "Euro 2006" me lojtarin që reagoi keq pas një zëvendësimi. Më pas mosaktivizimi me Spanjën bëri që Xhaka të largohet duke dhënë ultimatumin "kthehem kur të ikë De Biazi". De Biazi nga ana tjetër nuk denjoi t'i bënte ftesë futbollistit për ndeshjen me Izraelin, duke theksuar se sa kohë të ishte ai, mesfushori mund të vazhdohte të qëndronte larg Kombëtares, pasi nuk do të kthehej aty pa kërkuar falje. Por me De Biazin tashmë të dorëhequr, ka qenë Kristian Panuçi, ai që ka dashur të takojë lojtarin, duke e vënë të parin në listën e një axhende të gjatë takimesh. Por Xhaka jo vetëm që nuk e ka takuar trajnerin, por e ka lënë në pritje plot 3 orë pas takimit të së dielës mes Bazelit dhe Luzernës, kur mesfushori ngrohu stolin për 90 minuta. Ndonëse Panuçi ka këmbëngulur me disa SMS për të bindur lojtarin të ndërrojë mendje, Xhaka ka refuzuar t'i kthejë përgjigje,

18

**NDESHJE**  
Ka koleksionuar Xhaka me fanellën kuqezi. Ai ka debutuar më 7 shtator të vitit 2014 në fitoren e Shqipërisë me rezultatin 1-0 në Portugal.



duke i vënë kështu kapak aventurës së tij me Shqipërinë, pasi sjellje të tilla janë toltalisht të papranueshme kur në mes është fanella e kombit. "Taulant Xhaka e ka problemin te vetja, jo te trajneri i Kombëtares", pat thënë asokohe De Biazi dhe duket se ka

pasur të drejtë. Ndërkohë nga ana e lojtarit nuk ka pasur asnjë reagim për këtë situatë, por një sjellje e tillë nuk është diçka e re. Taulant Xhaka njihet si një lojtar gjaknxehtë, me një temperament të vështirë, por që asgjë nuk justifikon një sjellje të tillë. Por situata e lojtarit

nuk është aspak e mirë as te Bazelit. Trajneri i Bazelit, Rafael Viki, po përdor një skemë të re 3-5-2 për kampionatet e Zvicrës dhe një nga emrat e sakrifikuar është ai i Xhakës, që duhet të ulet në stol. Për momentin, ai nuk është zgjedhje e parë në mesfushë dhe në Zvicër, mediat

vendëse e shohin atë si një "alternativë" ndaj titullarëve, edhe pse gjatë viteve të fundit ka qenë ndër lojtarët më të qëndrueshëm për Bazelin. Por te klubi i tij, ndryshe sa ka ndodhur në përfaqësuese, Xhaka po e pranon vendimin e trajnerit në heshtje.

### Fshehja e taksave

## Ronaldo akuzon: Jam këtu sepse jam Kristiano Ronaldo



**K**ristiano Ronaldo ka dalë dje para Gjykatës së Shkallës së Parë të Alarkonit për të dëshmuar në lidhje me akuzat për evazion fiskal të ngritura nga prokuroria. Ai dyshohet se ka fshehur nga shteti spanjoll një shumë prej 14.7 milionë eurosh. Portugezi

refuzoi të komentonte për mediat atë çfarë tha para gjykatësit, por prestigjiozja spanjolle "AS" ka zbuluar se ai ka thënë që është duke u akuzuar pa të drejtë vetëm për faktin se është një person publik shumë i njohur. "Nëse nuk do të quhesha Kristiano Ronaldo,

nuk do të isha këtu", mësohet se i ka thënë Ronaldo gjykatësit. Ky i fundit nuk e pëlqeu aspak këtë fjalë të portugezitet dhe iu përgjigj: "Mos u gaboni, njësoj si ju këtu janë ulur shumë njerëz të tjerë të panjohur. Ju jeni këtu sepse po hetoheni dhe akuzoheni nga prokuroria mbi disa prova për të cilat drejtësia duhet të marrë një vendim". Megjithatë, Ronaldo vazhdoi të këmbëngulë në idenë e tij duke thënë sërish: "Jo, jo, gjithçka që po ndodh është sepse unë jam Kristiano Ronaldo".

### SERBI



## Zyrtare: Matić transferohet te Junajtidi

**N**emanja Matić është lojtari më i ri i Mançester Junajtidi, i cili ka nënshkruar një kontratë 3-vjeçare, me një mundësi për ta rinovuar edhe për një vit tjetër. Serbi ishte kërkesë e Murinjios, i cili ka bashkëpunuar më parë me të edhe tek Çelsi. Londinezët pranuan ta lënë të lirë lojtarin pas nënshkrimit me mesfushorin francez Bakajoko nga Monako. Në fjalën e tij të parë si "djall i kuq", Matić u shpreh: "Jam i kënaqur që jam bashkuar me Mançester Junajtidi. Për të punuar me Hose Murinjo edhe njëherë ishte një mundësi që nuk mund hidhja poshtë. Unë kam shijuar kohën time në Çelsin dhe do të doja të falënderoja klubin dhe tifozët për mbështetjen e tyre. Pres me padurim të takoj shokët e rinj të skuadrës dhe të filloj trajnimin me ta. Kjo është një kohë mjaft emocionuese për klubin dhe unë pres që të luaj rolin tim në krijimin e historisë për këtë klub të madh". Matić do të mbajë numrin 31 tek "dajjtë e kuq" dhe shihet si një nga pikat më të rëndësishme për sezonin e ri.

### Mesfushori aktivizohet te Novara

## Italianët zbulojnë akordin e Partizanit me hungarezin Adorjan



visien holandeze, aty ku futbollisti i lindur në Budapest

realizoi 3 gola në 19 ndeshje të luajtura. Prej vitit 2014 Krisztian Adorjan mbron ngjyrat e italianëve të Novarës. Ai ka luajtur me piemontezët nga Seria C dhe në Serinë B gjatë dy sezoneve të fundit. Në edicionin që kaloi mesfushori regjistroi 25 ndeshje, nga të cilat u aktivizua si titullar në 11 raste. Sipas të përditshmes italiane "Tuttosport", Novara ka vendosur ta transferojë mesfushorin ofensiv te Partizani, me të kuqtë që kërkojnë lojtarë cilësorë në sulm, pas largimit të

### Turkoviç ka nisur provën me kuqeblutë

## Një gjigant boshnjak për sulmin e Vllaznisë




Travnik, Akzhaik, Azal, Olimpik Sarajevo, Lovçen dhe së fundmi te skuadra sllovake Breziçe 1919. Vllaznia gjatë fazës përgatitore që është

të duke zhvilluar ka planifikuar edhe disa miqësore për të vlerësuar më së miri cilësitë e futbollistëve që do të jenë në provë.

**G**oditja e parë e madhe e Luçiano Moxhit te Partizani do të jetë Krisztian Adorjan. 24-vjeçari nga Hungaria pritet të jetë përforsim i bujshëm i të kuqve për sezonin e ri. Edhe pse mund të jetë një emër i panjohur për tifozët shqiptarë, mesfushori me tipare sulmuese ka një të kaluar të rëndësishme. Prej vitit 2009 ka qenë pjesë e Akademisë së Liverpullit, duke kaluar deri në ekipin e parë të gjigantëve anglezë, por pa arritur të luajë asnjë ndeshje. Në edicionin 2013-2014, "Reds" e huazuan te Groningeni në Eredi-



**Fjalëkryqi (1)**



HORIZONTAL

1. Riza aktor.
7. Një fjalë si hiç.
11. Një mund të jetë diplomatik.
12. Premtim të bëhet as.
14. Janë felinë... të zinj.
16. Ami i Maupassant.
18. Heroi i Emilio Salgarit.
19. Qe anarkist i famshëm rus
21. Një mungesë gjaku.
22. Susanna shkrimtare
23. Të parat në cilësi.
25. Mbyllin një shtëpi.
26. Mbeten në fund.
27. Qendër në kaos.
28. Ka brirë piktoreskë një i tillë
30. Inicialet e Camus.
31. Motra... e Kolë Idromenos
33. Një konfuzion total.

34. Rastet pa set.
36. Rastisin në krye.
37. Fillojnë detyrën.
38. Bektashi këngëtare.
39. Andrea aktore.
41. Sampras i tenisit.
43. Shkroi Korbi (indic).
44. Triolet e Trëndafilë me kredi.
46. Kilmer aktor.
47. Në krye të robotëve.
49. Unë dhe ti.
50. Një mund të jetë fetar.
51. Stephane poet francez

VERTIKAL

1. Fillojnë praktikën.
2. Britma e Arkimedit.
3. Ekstre me trap.
4. Në fund të fundit.
5. Janë fjetoret e ushtarëve
6. Parker regjisor.
7. Vivaldi kompozitor.
8. Një shkop për karambol.
9. Janë firmat rentiere.
10. Një i fundit mbi të gjithë
11. Kufizojnë tatimet
13. Janë nomadë.
15. Panik pa kufij.
16. Fryn detin
17. Sidney regjisor i Serpico.
18. Jep alarmin.
20. Fillojnë nazet.
24. Janë llogari.
25. Alan regjisor.
29. Roman regjisor.
32. Eshhtë X ajo e sulmit.
33. Kapen të parat.
35. Një provë... inteligjence.
37. Një markë lap top.
40. Fillojnë matjet.
41. Rruge e Ferenc Molnar.
42. Qerre pa qe.
45. Fillojnë lirinë.
46. Fillojnë vallenë.
48. Në mes të dhomës.

**Fjalëkryqi (2)**


HORIZONTAL

1. Një doktor... i Fritz Lang
6. U paraprinë hoteleve.
11. Kush nuk ka... nuk ha
13. Eshhtë djall
14. Një mund të ketë i rrallë.
15. Ishin perëndi të Samotrakias.
17. Institucione Botuese Autonome.
18. Eshhtë infeksion në bark
20. Fundi i një samurai.
21. Një markë kafeje.
22. Mbyllin një hark.
23. Mund të jetë emërore.
25. Ishte muzikanti që nuk përsriste.
28. Në krye të avokatëve.
29. Qerre pa qe.
30. Një pjesë e adoleshentëve.
32. Një banor imagjinar i planetit të kuq.


35. Nuk shuhej dot nga Tantali.
36. Desnuda e Goya-s.
37. Ruhet ajo sportive.
39. Vetëvrasia e samurait.
41. Drita pa kufij.
43. Eshhtë yll i skuadrës.
44. I dashuri i Aidas.
46. Eshhtë zhurmë
47. Ishte lulja e harresës.

VERTIKAL


1. James, armiku i Sherlock Holmes.
2. Eshhtë edhe ajo saudite.
3. Imami aktore
4. I kanë çift turket.
5. Inicialet e Seagal aktor.
6. Eshhtë dëshmore... çudibërëse.
7. Në fund të lutjes.
8. Eshhtë sporti me stil të lirë.
9. Mbeten në fund.
10. Eshhtë rasti i veçantë, karakteristik.
12. Conan ai i Schwarzenegger.
13. Gjysmë ditari.
15. Mario, që qe bomber argjentinaz.
16. Mund të prishej nga një... kleçkë.
18. Në hyrje të pistës.
19. Një numër... femrash.
21. Eshhtë qyteti i Besës
24. Qyteti që quhej edhe Sebaste.
26. Njëlloj për latinë.
27. Mund të bëjnë stil të lirë.
31. Damon aktor.
33. Eshhtë pije e jona.
34. Në krye të noterëve.
36. Film i Robert Altman.
38. Skuadra merengue.
39. Një pjesë e hasmërisë.
40. Rrallë eshtë përgjysmë.
42. Nisur pa kutij.
45. Fillojnë mobilizimin.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave



**SUDOKU**

6	9		3					8
	1		5	2				
		7				6	3	1
			5	2	6		1	9
	3		9		4			7
	4	2		5	1	8		
4	5	3				7		
				7	8		1	
8					5		2	9

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**


2	1	3	4	8	6	5	7	9
7	9	8	3	1	5	4	2	6
4	5	6	9	7	2	8	3	1
3	6	4	1	5	8	2	9	7
9	7	5	6	2	3	1	4	8
1	8	2	7	9	4	3	6	5
5	2	7	8	4	9	6	1	3
6	4	9	5	3	1	7	8	2
8	3	1	2	6	7	9	5	4

*Argëtim filozofik*

- Siç nuk mund të qortohet veprimi i pavetëdijshëm, kështu nuk mund të lëvdohet as mirëbërësia e detyruar. **Euripidi**
- Shumë njerëz duhen nderuar jo sepse bëjnë mirë, por sepse nuk bëjnë keq. **Helvec**
- Dikush nga ne i bën gjërat mirë, dikush tjetër jo, por të gjithë së bashku do të gjykojmë nga një gjë e vetme: rezultati... **(Vincent Lombardi)**

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm



*Ehënie të mençura*

- Çdo njeri është gjeni të paktën një herë në vit, një gjeni i vërtetë ka ide origjinale gjithnjë të pranishme. **(G.C.Lihtenberg)**
- Pranojeni vendin që ka caktuar për ju i plotfuqishmi, shoqëria e bashkëkohësve tuaj dhe lidhja midis ngjarjeve. **(Ralf Valdo Emerson)**
- Ka njerëz që dinë gjithçka, por fatkeqësisht është gjithçka që dinë. **Oscar Wilde**
- Ruaje dashurinë në zemër, sepse një jetë pa dashuri është si një kopsht pa diell, ku lulët janë vyshkur.
- Ka vetëm një gjë të tmerrshme në botë, vetëm një mëkat të pafalshëm; mëzria. **Oscar Wilde**

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

# GAZETA SHQIPTARE

# GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

# GSH

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

## GAZETA SHQIPTARE



## Tashmë edhe lundroni!

